

PROF.DR.HFZ  
HAJREDIN HOXHA

SHQYRTIMI  
ANALITIKI  
FUNKSIONALIZIMIT  
TË SHKENCAVE TË  
KUR'ANIT NË DA'VET

Shembuj konkret - shkenca e  
ajeteve mekase dhe medinase



Doc.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

---

# SHQYRTIMI ANALITIK I FUNKSIONALIZIMIT TË SHKENCAVE TË KUR'ANIT NË DA'VET

(Shembull konkret - shkenca e ajeteve mekase dhe medinase)

---

Simpozium ndërkombëtar për zhvillimin e studimeve kur'anore në Riad, Arabia Saudite

16-20.02.2013

Përktheu nga arabishtja  
Doc. Dr. Muhamed Mustafa

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

Në emër të Zotit, Bamirësit, Mëshirëbërësit të përgjithshëm!

## HYRJE

Falënderimi i takon Zotit të botëve! Salavatet dhe selami qofshin mbi Pejgamberin e pejgamberëve dhe të dërguarve, mbi Pejgamberin tonë, Muhammedin a.s., mbi familjen e tij, mbi sahabët e tij dhe mbi të gjithë ata që ecin rrugës së tyre deri në Ditën e Gjykimit!

Kur'ani Famëlartë është gjëja më e madhëruar që meriton t'i kushtohet shumë kohë dhe që t'i përkushtohet një studim jetësor. Zoti i Madhëruar e nderoi ummetin islamik me dërgimin e Pejgamberit prej mesit të tyre, që ua lexon ajetet e Tij, i pastron ata dhe ua mëson atyre Kur'anin e urtësinë. Zoti i Madhëruar thotë:

*“Është e vërtetë se All-llahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t'u lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kur'anin dhe sheriatin, edhe pse, më parë ata ishin krejtësisht të humbur.”* (Ali Imran, 164)

Ai (xh.sh.) po ashtu ka bërë njerëz më të mirë, sepse urdhërojnë në të mirë dhe ndalojnë nga e keqja:

*“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija...”* (Ali Imran, 110)

Zoti i Madhëruar, po ashtu, e ka bërë Kur'anin si udhërrëfyes në atë që është më e fuqishme:

*“Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh.”* (El-Isra, 9).

Ai e bëri atë dritë dhe argument për botët:

*“O ju njerëz, juve ju erdhi nga Zoti juaj argument dhe Ne ju zbritëm dritë të qartë.”* (Nisa, 174).

Zoti i Madhëruar iu premtoi besimtarëve fitoren, përkrahjen, fuqinë dhe mundësinë me kusht që ta përcjellin Kur'anin, t'i ndihmojnë fesë islame, t'i përkulen Zotit të Madhëruar, t'i nënshtrohen Pejgamberit a.s., t'i respektojnë urdhrat dhe të largohen nga të ndaluarat e Tij, t'i zbatojnë parimet, të lejojnë atë që Ai e ka bërë hallall dhe të ndalojnë atë që Ai e ka bërë haram:

*“O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) All-llahun, Ai ju ndihmon juve dhe u forcon këmbët tuaja.”* (Muhamed, 7)

*“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit.”* (Nur, 55)

Synimi primar i zbritjes së Kur'anit Famëlartë është udhëzimi i njerëzve në rrugën e drejtë e të vërtetë:

*“Udhëzim dhe përgëzim për besimtarët.”* (Neml, 2)

*“Ky është libri që nuk ka dyshim në të (sepse është prej All-llahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm.”* (Bekare, 2)

*“Zbritja e Kur'anit është padyshim nga Zoti i botëve.”* (Sexhde, 2)

Synimi i tillë i lartë dhe primar nuk kundërshtohet me Kur'anin Famëlartë në sferën e tregimeve dhe të disa shkencave humane e sociale. Në shumë ajete të Kur'anit Famëlartë theksohen të dhëna nga astronomia, kimia, fizika, matematika, inxhinieria, gjeologjia, shkencat detare, embriologjia, medicina, ekonomia dhe shkenca e arte të tjera, të cilat ishin të dobishme për disa dijetarë të famshëm, që thoshin se Kur'ani Famëlartë i përmban shkencat e të parëve dhe të mëvonshmëve.

Ndër mënyrat e mbrojtjes së Kur'anit Famëlartë nga Zoti i Madhëruar është ajo e mësimi përmendsh të çdo rreshti, leximi i shpeshtë, komentimi nëpër libra, mbrojtja nëpër librari, shkolla e universitete si dhe shënimi i të gjitha shkencave dhe arteve me shembuj konkretë. Po ashtu, ekzistojnë shumë hulumtime e studime, si p.sh., shkenca e ajeteve mekase e medinase, të përgjithshme dhe të përveçme, absolute dhe konkrete, shkenca e leximeve dhe e shtatë shkronjave, ndarjet dhe shembujt, rrëfimet kur'anore, stilistika, mrekullia, leximi reprezentatues i Kur'anit, abrogimi dhe derogimi, të qartë e të paqartë etj. I pastër nga të metat është Ai që ka mbjellë në zemrat e robërve të Tij të sinqertë dashurinë ndaj Kur'anit Famëlartë, i cili, si libër i fundit, konsiderohet mrekulli hyjnore për të gjitha gjeneratat në çdo kohë dhe në çdo vend. Ky libër vlen, po ashtu, për të gjitha kohërat dhe për të gjithë njerëzit deri në Ditën e Gjykimit.

Dijetarët klasikë dhe bashkëkohorë janë unanimë rreth mendimit se shkencat më të respektuara janë ato që kanë të bëjnë me librin e Zotit të Madhëruar dhe që janë në shërbim të tij. Ata, po ashtu, janë unanimë se forma, shkrimi, ajetet, suret, fjalët e fjalitë si dhe përmbajtja e Kur'anit Famëlartë, duke përfshirë edhe ligjet, parimet e rregullat, janë mrekulli hyjnore që vlejnë për të gjitha kohërat dhe për të gjitha vendet si dhe janë të paarritshme për të gjithë njerëzit, të cilët as që mund të sjellin diçka të tillë. Në bazë të kësaj që u theksua, dëshiroj të përmend një çështje shumë të rëndësishme, gjegjësisht faktin se çdo shkencë i shërben Kur'anit Famëlartë dhe në një farë mënyre gjithashtu konsiderohet mrekulli, sepse ka të bëjë me Librin që është mrekulli. Format e mrekullisë së shkencës së tillë dalin në pah kur zbërthehen në suaza të shkencave që kanë të bëjnë me Kur'anin Famëlartë, dhe gjërat e tilla janë të shumta në lëndën e shkencës së Kur'anit.

Çështjet e tilla janë të ndërlydhura po ashtu edhe me shkencat tjera që mund të aplikohen e të realizohen.

Thënë shkurt, përmes këtij studimi ftoj në një metodologji të re për t'u ndërlydhur me shkencat e Kur'anit, gjegjësisht funksionalizimin pozitiv të shkencave të tilla që kanë të bëjnë me Kur'anin Famëlartë në jetën tonë të përgjithshme dhe private, si individ, shoqëri e ummet, qoftë nga aspektet edukative, të da'vetit, akademike ose etike.

Ndoshta kjo orvatje personale është një hap i parë që do të pranohet dhe, më pas, gjatë studimeve të mëtejshme të Kur'anit Famëlartë, do të zhvillohet nga hulumtuesit e studiuesit e tjerë.

## **QËLLIMI I PUNIMIT**

Në këtë punim shkencor dëshiroj të shqyrtoj dy çështje, gjegjësisht njërin prej tyre nëse ma mundëson punimi në fjalë, dhe këto dy çështje kanë të bëjnë me shkencat e bekuara të Kur'anit, konkretisht me shkencën e ajeteve mekase dhe medinase si dhe me shkencën e zbritjes së njëpasnjëshme të ajeteve të Kur'anit, për të kuptuar mënyrën e funksionalizimit të këtyre dy shkencave dhe mënyrën e përfitimit të dobive prej tyre në sferat e sipërpërmendura. Besoj se me këtë metodologji të re, - në bashkëpunim me shkencat e Kur'anit (ose me shkencat e tefsirit), madje edhe me shkencat e sunnetit, ose me rregullat usuliste ose juridike dhe me funksionalizimin e tyre në realitetin tonë bashkëkohor, - do të dalim në mënyrë të drejtpërdrejtë nga bota e teorive e ideve në botën e rezultateve dhe në aplikimet bashkëkohore të parimeve dhe rregullave islame. Ky është fryti i vërtetë i shkencave dhe i njohurive të sheriatit ose jo të sheriatit. Po ashtu do të mbështetemi në marrjen kualitative të shkencave që janë në shërbim të Kur'anit Famëlartë si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen, bile edhe në të ardhmen, inshaallah!

### **Arsyet e studimit**

Një orvatje e tillë e përpunimit të shkencave të Kur'anit ose të shkencave të tefsirit është thjesht personale, dhe ekzistojnë dy arsye që ndikuan dukshëm që t'i qasem kësaj çështjeje. Arsyeja e parë ka të bëjë direkt me jetën, aktivitetin dhe punën time në profesionin e da'vetit, imamatit dhe ligjëratarëve në vendlindjen time në Kosovë, e në disa shtete perëndimore dhe aziatike, si p.sh., në Gjermani, Zvicër e Malajzi, pastaj puna ime konkrete në da'vet dhe kontakti im i drejtpërdrejtë me ftuesit në fe (da'vetçinjtë), me dijetarët arabë dhe joarabë, shqiptarë, turq, boshnjakë, malajzianë, indonezianë, brunejanë, kinezë, indianë, palestinezë, saudianë, katarianë, irakianë, sirianë, jemenas, egjiptianë, sudanezë, algjerianë, marokenë, maritanasë dhe disa dijetarë nga Afrika.

Arsyeja e dytë ka të bëjë edhe me eksperiencën time akademike në ligjërimitin e lëndës së "shkencave të Kur'anit, të tefsirit, të mrekullisë së Kur'anit, të drejtiveve bashkëkohore në tefsir, hyrjen në Kur'an e sunnet, metodat e komentuesve dhe të lëndëve të tjera për studentë e studente në gjuhën arabe e angleze në baçelor dhe studime të larta si dhe në mentorimin e mbrojtjen e disa disertacioneve shkencore në magjistratura. E kam ushtruar profesionin e arsimit, madje ende e ushroj të njëjtën punë, afro dy dekada në universitete të ndryshme, dhe për këtë e falënderoj Zotin e Madhëruar.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Në disa shtete të Gjirit Arab dhe në Saudi: Universiteti Tajiba në Medinë - Fakulteti i sociologjisë, i da'vetit dhe letërsisë; Në Universitetin e Katarit - Fakulteti i sheriatit dhe

## Studimet e mëhershme dhe standardet e tyre

Ligji i Zotit ka caktuar që në çdo çështje shkencore intelektuale të ketë punime, hulumtime e orvatje shkencore paraprake, por kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se të parët nuk kanë lënë gjë për të mëvonshmit. Çështja nuk është ashtu siç mendojnë disa njerëz, sepse secili e ka mundësinë, sferën dhe aktivitetin e tij të kufizuar brenda diapazonit njerëzor. Sa shumë kanë bërë të parët për pasardhësit e tyre? Kjo gjë ka ndodhur vërtet dhe në bazë të kësaj të vërtete shkencore, e cila unanimisht është e pranuar, them se çështja e hulumtuesve ose e studiuesve të mëparshëm rreth shkencës së ajeteve mekase dhe medinase i takon kësaj kategorie.

Gjatë hulumtimit tim shkencor kam vërejtur dallime relative në potencialin e dijetarëve të tillë të nderuar gjatë zbërthimit të tematikës mekase dhe medinase, sepse secili prej tyre e shqyrtonte çështjen nga aspekti i tij shkencor, në bazë të orvatjes së tij të kufizuar individuale. Nëse i shikojmë me vëmendje studimet e tyre, do të kuptojmë plotësisht se vetëm pak prej tyre e kanë shqyrtuar funksionalizimin e shkencës së ajeteve mekase dhe medinase në da'vet apo në arsim. Studimet e shumicës së tyre, qofshin të mëhershëm apo të mëvonshëm, kanë qenë brenda kallëpeve dhe formave të ndryshme, pa ndonjë dallim rrënjësor tematik, ashtu siç do të vërejmë në vazhdimin kritik. Unë them se studimi im shkencor rreth ngritjes së funksionalizimit pozitiv të shkencave të Kur'anit nuk është diçka e përsëritur ose veç e parë, sepse gjatë hulumtimit dhe angazhimit tim në këtë tematikë (tematika mekase dhe medinase), kam arritur në përfundimin se studimet e mëparshme rreth kësaj tematike kanë pasur disa standarde të ndryshme. Studimet e tilla kanë pasur:

- \* Standarde statistikore duke i numëruar ajetet dhe suret mekase dhe medinase dhe duke pasur qëndrime të ndryshme.

- \* Standarde përkufizuese-specifike duke i theksuar shenjat dhe karakteristikat e ajeteve e sureve mekase dhe medinase.

- \* Standarde historike duke i shënuar arsyet dhe shkaqet e zbritjes së ajeteve e sureve mekase dhe medinase.

- \* Standarde edukative duke i theksuar aspektet dhe mënyrat edukative të ajeteve mekase dhe medinase.

Pra, kështu ishte pjesa dërmuese e studimeve të mëparshme, madje mund të thuhet edhe të gjitha studimet në trajtimin e ajeteve mekase dhe medinase.

- \* Standarde të da'vetit duke i shqyrtuar çështjet që kishin të bënin me da'vetin në disa ajete e sure mekase dhe medinase.

---

i studimeve islame si dhe në disa shtete islame në juglindje të Azisë-Malajzi, Universiteti Ndërkombëtar Islamik - Fakulteti i njohurive të shpalljes dhe shkencave humane në degën e studimeve kur'anore dhe të hadithit, në Fakultetin e usuluddin në Universitetin Islamik të Sulltan Sherif Aliut në Sulltanatin e Bruneit.

\* Standarde intenciale duke shqyrtuar fshehtësinë e përqendrimit të Kur'anit në intencat e shariatit të ajeteve dhe sureve mekase e medinase.

Edhe pse studimet me standarde të da'vetit e edukatës janë të pakta, do të orvatem që të jap kontributin tim më të mirë për funksionalizimin e shkencës së ajeteve mekase dhe medinase në jetën tonë dhe, nëse do të ekzistojnë studime të tilla edhe në të ardhmen, ato do të quheshin studime me standarde funksionale.

Në hulumtimin tim nuk kam për qëllim që t'i shqyrtoj studimet e mëparshme brenda standardeve të kaluara, por përfitova shumë nga studimet e Akademisë së Mbretit Fehd për botimin e Kur'anit në Medinë, duke shfletuar veprat që më ndihmuan dhe më begatuan tej mase:

“Nuzulul-Kur'an”

\* Zbritja e Kur'anit, Dahhak ibën Mezahim El-Hilalij (104 hixhri).

\* “Nuzulul-Kur'an”, Ibën Ebi Abdullah Kureshij Berberij (105 hixhri).

\* “Nuzulul-Kur'an”, Hasan ibën Ebi Hasan Basrij (110 hixhri).

\* “Et-tenzil fill-Kur'an”, Ali ibën Hasan ibën Feddal El-Kufi (224 hixhri).

\* “Tenzilul-Kur'an”, Muhamed ibën Muslim ibën Shihab Zuberij (124 hixhri).

\* “Fedailul-Kur'an ve ma unzile minel-Kur'an bi Mekketi ve ma unzile bil-Medineti”, Ebu Abdullah Muhamed ibën Ejub ibën Durejn (294 hixhri).

\* “Bejani adedi suveril-Kur'an ve ajatihi ve kelimatihî ve mekkijje ve medenijje”, dhe në këtë kopje është mbështetur komisioni që ka mbikëqyrur botimin e Mus'hafit të Medinës.

\* “Tenzilul-Kur'an”, Ebu Zehra Abdurrahman ibën Zenxhele El-Mukrimi (403 H.).

\* “Et-tenzil ve tertibuhu”, Ebu Kasim Hasan ibën Muhamed Nisaburi (406 hixhri), dorëshkrim që është pjesë e librit të tij voluminoz: “Et-tenbih alal fadli ulumil-Kur'an”.

\* “Kitabul-mekkiy vel-medenij”, Mekkiy ibën Ebi Talib El-Kajisij (437 hixhri).

\* “El-Mekkiy vel-Medinij fil-Kur'an ve ihtilaful-mekkiy vel-medenij fi ajetin”, Ebu Abdullah Muhamed ibën Shurejh Er-Re'inij (476 hixhri).

\* “Jetimetud-durer fin-nuzuli ve ajatus-suveri”, Ebu Abdullah Muhamed ibën Ahmed Hanbeli Mukri'ë (656 hixhri), dorëshkrim.

\* “Kitabul-Mekkiy vel-Medenij fil-Kur'an”, Abdulaziz ibën Ahmed Dejremij (694 hixhri).

\* “El-Erxhuzetu el-mutedaruminetu ma'rifetil-mekkiy vel-medenij min suveril-Kur'anil-Kerimi”, Bedruddin Muhamed ibën Ejub El-Hanefij (705 hixhri), dorëshkrim.

\* “Tekribul-me'mul fi tertipin-nuzul”, Burhaneddin Ibrahim ibën Umer Xhaberij Mukri'ë (732 hixhri), dorëshkrim.

\* “El-Kalem ala emakini minet-teuzili”, Ibën Ebi Sherif Burhaneddi Ebu Is'hak Ibrahim ibën Muhamed Shafi'ij (923 hixhri), dorëshkrim.

\* “Risaletul Aufij fil-mekkiy vel-medenij ven-nasih vel-mensuh ve adedul-ajati”, Muhamed ibën Ahmed Ufi (1050 hixhri), dorëshkrim.

\* “Erxhuze fil-Kur’anil-mekki vel-medenij ve ma fi ta’dudihi minel-hilaf”, Muhamed ibën Ahmed Bazan Huzani (1216 hixhri), dorëshkrim.

### **Studime bashkëkohore që kanë të bëjnë me ajetet mekase dhe medinase**

1. “Ehemmu hasaisis-suveri vel-ajatil-mekkiijeti ve mekasiduha”, Dr. Ahmed Abbas Bedevi.

2. “Hasaisus-suveri vel-ajatil-mdenejjeti, davabituha ve mekasiduha”, Dr. Adil Ebi El-UI-la.

3. “El-Mekki vel-Medenij fil-Kur’anil-Kerim”, studim i thellë kritik i sureve dhe ajeteve që nga fillimi i Kur’anit deri në fund të sures El-Isra, temë magjistrature e hulumtuesit Abdurrezak Husein Ahmed.

4. “E-Mekki vel-Medenij fil-Kur’anil-Kerim”, prof. dr. Muhamed ibën Abdurahman Esh-Shaji’u.

5. “Mukadime fi hasaisil-kitabil-Kur’anij bejnel-ahdejni el-mekki velmedenij”, dr. Sejjid Abdulmaksud Xha’fer.

6. “El-Mekki vel-Medenij”, hulumtuesi Muhamed Shefa’at Rabbani.

“Ilmul-mekki vel-medenij fi ujunil-musteshriketi, prof. dr. Zejd Umer Abdullah El-Ajs.

8. “Mekkujul-Kur’ani ve medenijjuhu”, Muhamed Hadi Keridan.

9. “Et-tejjarul-ilmani el-hadith ve meukifuhu min tefsiril-Kur’anil-Kerimi”, studim dhe kritikë, Muhamed Muhamed Behijuddin Esh-Shafi’ij.

10. “El-Ilmaniijun vel-Kur’anil-Kerim - tarikijjetun-nassij”, dr. Ahmed Idris Ta’an.

11. “El-It-tixhahul-ilmanij el-mu’asir fi ulumul-Kur’anil-Kerim”, studim dhe kritikë, dr. Ahmed muhamed Fadil.

12. “El-Ajatul-mekkiye” - “Studim nga aspekti edukativ peripatetik”, hulumtuesja Zuherijat bint Jusuf.

13. “Fikhul-Kur’anil-Mekki”, hulumtuesi Abdulkadir Hudar.

14. “El-Mekki vel medenij ve etheruha fid-da’veti”, dr. Ammar Muhamed Ammar.

15. “El-Medenij vel-mekki” - shqyrtime dhe komente, hulumtuesi Fevvaz Ahmed Tukan.

16. “Nadhratun xhedidetun fi mekkijjis-suveri ve medenijjiha”, hulumtuesi Abdulah Sa’idi.

17. “El-Keulush-shexhxhij fil-mekki vel-medenij”, hulumtuesi Husein Tal’at Hitab.

18. “El-Hitab ed-da’vij fis-suveril-mekkiijeti”, hulumtuesi Mu’tesim Abdulkerim Mitrij..

19. “El-Mekki vel-Medenij fil-Kur’anil-Kerim”, hulumtuesja Rena Ahmed Kudsij.

20. “El-Mekki vel-Medenij, ed-davabit vel-mitajat”, hulumtuesi Sejjid Selam Zejnul-abidin.



Si duket, pjesa dërmuese e studimeve të theksuara janë përsëritje e asaj që e kanë theksuar të mëparshmit, por me një dallim të vogël në formë e radhitje, përpos studimeve të nënvizuara, sepse të tilla kanë të bëjnë drejtpërdrejt dhe pjesërisht me hulumtimin tim.

Studimi i funksionalizimit pozitiv të shkencës së ajeteve mekase dhe medinase si dhe dobia prej tyre është me rëndësi të madhe.

### **Kompleksiteti i studimit**

Nuk ekziston ndonjë kompleksitet shkencor, dituror ose intelektual aq sa njoh dhe aq sa di unë për këtë studim, por ekziston një nevojë e domosdoshme për të ndërmarrë studime të tilla ripërtëritëse ose progresive të shkencave të Kur'anit Fisnik. Kjo orvatje individuale rreth paraqitjes së rëndësisë së këtij lloji të studimeve mund të jetë ftesë dhe thirrje për ringjalljen dhe zhvillimin e shkencave të Kur'anit, për të realizuar kuptimin e mrekullisë së plotë e të përgjithshme të Kur'anit Fisnik dhe të gjitha shkencave që janë në shërbim të Kur'anit Famëlartë.

Pra, çka është risi në këtë studim?

Risia në këtë studim ka të bëjë me dy gjëra e jo me tri gjëra. Gjëja e parë ka të bëjë me përcjelljen e përpiktë të fjalëve të disa dijetarëve klasikë e bashkëkohorë, rreth mënyrës së dobisë nga shkenca e ajeteve mekase dhe medinase, nga aspekti i përgjithshëm ose vetëm i pjesshëm, edhe pse ata (Zoti i mëshiroftë!) nuk kanë përpiluar vepra të posaçme rreth kësaj tematike.

Gjëja e dytë ka të bëjë me funksionalizimin pozitiv dhe me aplikimin praktik të çështjeve të tilla që kanë të bëjnë me shkencën e ajeteve mekase dhe medinase, si p.sh., karakteristikat e metodologjisë tematike të ajeteve mekase dhe medinase si dhe mënyra e përfitimit të dobisë prej tyre në sferën e da'vetit dhe arsimit. Nisur nga të vërtetat e tilla, do të orvatem që të sqaroj mënyrën e funksionalizimit dhe dobisë nga shkenca e ajeteve mekase dhe medinase gjatë përvojës personale në lëmin e da'vetit dhe jetës akademike, si dhe duke u mbështetur në thëniet e disa dijetarëve bashkëkohorë, të cilët thërrasin në përqendrimin në periudhën mekase dhe medinase gjatë da'vetit në Zotin e Madhëruar.

Lus Zotin që ky studim ose ky vizion progresiv i shkencave të Kur'anit të japë ndihmesë serioze në këtë rrugë, dhe me seriozitet të madh do të propozoja që sinqerisht të merren me këtë çështje ata që janë të interesuar për studimet kur'anore, ata që punojnë në sferën e edukatës dhe arsimit, ata që punojnë në ripërtëritje e ndryshime, në da'vet e ligjërata dhe ata që e ngrenë lartë flamurin e Kur'anit, që punojnë me mënyrën e Kur'anit, me udhëzimin dhe me metodologjinë e Kur'anit.

### **Metodologjia e studimit**

Studimi zhvillohet në bazë të metodës induktive, deskriptive dhe komparative dhe në këtë mënyrë punimin e kam ndarë në: hyrje, tre kapituj dhe përfundim.

## Kapitulli i parë

### NEVOJA PËR NJË STUDIM TË TILLË PROGRESIV TË SHKENCAVE TË KUR'ANIT

#### 1. Thënie nga selefët rreth domosdoshmërisë së zhvillimit të shkencave që kanë të bëjnë me Kur'anin Fisnik

Nevoja për të bërë një lloj studimi të tillë progresiv të shkencave të Kur'anit është shumë e madhe. Ata që merren me shkencat e Kur'anit dhe që janë në shërbim të tij duhet të mendojnë thellë rreth kësaj çështje dhe të hulumtojnë rreth mundësive të funksionalizimit pozitiv të disa shkencave të Kur'anit. Është për t'u habitur e çuditur fakti se edhe pse ekzistojnë shumë studime të ndryshme kur'anore, mungojnë studimet shkencore metodologjike profesionale rreth funksionalizimit pozitiv të disa shkencave që kanë të bëjnë me Kur'anin Fisnik. Dobia shkencore e mrekullisë së Kur'anit Fisnik nuk përfitohet vetëm përmes hulumtimit rreth urtësisë së ligjeve të shpallura kur'anore, por edhe përmes çdo shkence që është në shërbim të Kur'anit Fisnik. Të gjithë dijetarët janë unanimes se Libri i Zotit të Madhëruar është absolutisht gjëja më e ndershme dhe më e shenjtë, si dhe gjëja më e vlefshme për të cilën ata kanë shpenzuar kohën dhe jetën e tyre për ta studiuar.

Zoti e mëshiroftë Imam Ebu Bekër Bakilanin (402 hixhri), i cili për disa nocione thotë: “Gjëja më e çmueshme për ithtarët e fesë së Zotit është që të zbulojnë, madje në mënyrë prioritare, shtyllën e fesë së tyre, parimin e monoteizmit të tyre që konsiderohet bazë dhe sistem, atë që është fakt për sinqeritetin e Pejgamberit të tyre dhe fakt e argument për mrekullinë e tij, posaçërisht kur dihet se injoranca është përhapur përplot me hipokrizi në mbarë horizontin. Dituria është shndërruar në leksione të kota e të thata, ndërsa ithtarët e saj janë në një kohë shtazarake dhe krahasohen me luanin e ashpër, dhe ajo që ata ofrojnë është larg metodave dhe rrugës së saj.

Pra, njerëzit janë dy llojesh: njëri lloj është larg së vërtetës dhe rrugës së drejtë, ndërsa lloji tjetër është pa ndihmë dhe pa përkrahje, dhe e gjithë kjo ka ndikuar që ateistët të depërtojnë në bazat e fesë dhe t'i bëjnë të dyshojnë njerëzit e dobët për çdo të vërtetë. Ndhimësit e tyre janë të paktë, nuk kanë përkrahje, janë të braktisur nga familja dhe me ta luajnë të gjithë, saqë e tërë situata është rikthyer në atë që ka qenë më parë...<sup>2</sup>

Imam Bakilani (Zoti e mëshiroftë!) e përshkruan në mënyrë decime pjesën dërmuese të studimeve, për të cilat mendohet se janë në shërbim të Kur'anit, por realisht janë shumë larg prej tij, sepse merren me çështje shkencore teorike sekondare e me bazat e fesë së Zotit; ato as që konsiderohen shtyllë dhe themel të mendimit, as nuk argumentojnë sinqeritetin e Pejgamberit a.s. e as që ofrojnë argument e postulat për mrekullinë e tij. Ne gjithashtu, nga fjalët e Imam Bakilanit, kuptojmë se çdo shkencë ka

---

<sup>2</sup> Bakilani, *I'xhazul-Kur'an*, Darul-me'arif, Kajro, f. 4.

lidhje me shërbimin e Kur'anit Fisnik, qoftë nga aspekti faktik ose elokuent, madje edhe vetvetiu është mrekulli, sepse ka të bëjë me këtë Libër të shenjtë. Lidhja në mes tyre është e pandashme. Nëse të gjitha shkencat grafullojnë nga Kur'ani Fisnik apo Kur'ani i sinjalizon shkencat primare, atëherë mund të themi se çdo shkencë i shërben Kur'anit, duke grafulluar edhe shkencat të tjera, dhe këtë gjë e kuptojnë vetëm dijetarët e jo edhe injorantët. Mrekullitë, shkencat dhe artet e Kur'anit nuk përfundojnë asnjëherë, sepse ai është aktual në mënyrë të vazhdueshme sikur të shpallej sot, si dhe i thotë njeriut: urdhëro tek unë dhe gjeje jetën e mirë, lumturinë e vërtetë, diturinë dhe shkencën e re. Dikush që merrej me hulumtimin e shkencave të Kur'anit nxori disa shkencat të reja për të cilat nuk kanë folur të parët tanë. Shkenca e parë e re është “arti i zbukurimit në Kur’an”, shkencat e dytë: “Arti i qeshjes dhe i komedisë”, pastaj shkencat e tjera: “shkenca e fshehtësive...”<sup>3</sup>

Imam Abdulkadir Xhurxhani (Zoti e mëshiroftë!), që vdiq në vitin 471 hixhri, thekson funksionalizimin e një shkence tjetër nga shkencat e Kur'anit, që është e dobishme njësoj si shkencat e tjera që kanë të bëjnë me Kur'anin Fisnik, gjegjësisht shkencën e shembujve dhe ilustrimeve në Kur'anin Fisnik. Në këtë kontekst ai thotë:

“Dije se dijetarët janë unanimesë se nëse është ilustrim, përdoret me koncepte të përpikta, që janë shumë të thuktë, që ilustrojnë formën origjinale në mënyrë të mrekullueshme dhe precize e me domethënie të rëndësishme, ndikuese tej mase, nxitëse të shpirtit, atraktive për zemrat, me kuptime të largëta, me natyrë të afërt e të dashur. Nëse lavdëron është i qartë dhe i pasur, me ndikim të lartë në shpirt, i dridh ndjenjat, është praktik, ndez lumturinë dhe e mbron tërësisht të lavdëruarin, obligon ndërmjetësim për lavdëruesin, iu ofron çdo gjë tej mase, me fjalë të lehta e që mbahen mend, e ngjitet menjëherë në zemër. Nëse është qortim, ka ndikim të dhimbshëm, irritues, të mprehtë, të ashpër. Nëse është mbulesë, ka veprime të ndritshme, fuqi të madhe, fjalë të kthjella. Nëse është krenari, ka shprehje të saktë, autoritare, me gjuhë të ëmbël. Nëse është kërkim faljeje, pranimi është më i afërt, më afër zemrës, më i hidhët për të këqijë, për të hidhëruarit është sulm dhe për ata që fryjnë për të keq sulm, për rikthim të mirë më i kapshëm. Nëse është kështu, është më i shërueshëm për zemrën, më përsiatës, më i qartë në kujdes, zbulues, tregon qëllimin, shëron të sëmurin. Pra, kështu ndodh nëse i lexon me vëmendje artet e fjalës dhe shprehjes, me derë e pjesë të ndryshme...”<sup>4</sup>

Pra, nëse këto shkencat, që kanë të bëjnë me Kur'anin Fisnik, bëhen funksionale në aspektet e da'ves, arsimit e kulturës, nuk ka dyshim se do të realizohet obligimi ynë i madh ndaj mësimin tonë fetar, në da'vetin islamik, në edukatën e gjeneratave me edukatë të shëndoshë në dritën e ajeteve kur'anore dhe shkencore të ndërlidhura me të.

---

<sup>3</sup> Dr. Abdulkadir Mensur, imam dhe ligjërues në Xhaminë Sejfid-deuleti në Halep. Lus Zotin që atij, banorëve dhe ushtrisë së lirë t'u ndihmojë Zoti që të triumfojnë sa më shpejt ndaj kthetrave të sistemit vrasës të Asadit, i cili bën masakër mbi të paafët, pleqtë, gratë e fëmijët... “*Meusuatu ulumul-Kur'an*, Darul-Kalem, bot. I, 2002, f. 7.

<sup>4</sup> El-Xhurxhani, *Esrarul-belaga*, Mektebetul-mishkat el-islamijeti, në internet: [www.almishkat.net/books/php?book=1458.cat=16](http://www.almishkat.net/books/php?book=1458.cat=16)

Imami dhe komentuesi Ebu Saud, në tefsirin e tij, thekson rëndësinë e kësaj shkence:

“Ilustrimi bëhet vetëm me fjalë të caktuara për çështje të njohura, ai e zbukuron racionalen me atë shqisore, i parashtron konceptet në formë të njohur, largon iluzionin nga kundërshtimi ndaj intelektit, i nxjerr të vërtetat e fshehta, i bën të kuptohen çështjet me përputhshmëri të plotë për të vazhduar në atë që duhet, e mënjanon të panevojshmen dhe për këtë shkak numri i shembujve në librat hyjnorë dhe në fjalët pejgamberike është i madh. Këto ishin të njohura në shprehjet e elokuentëve dhe në thëniet e të mençurve. Ilustrimi është mënyra më e mirë për nënshtrimin e iluzionit para intelektit dhe për mbrojtjen e pozitës së duhur, forma më e mirë për ta bërë injorantin të kuptojë, pasi i bën fjalët të nguliten. E si të mos jetë kështu kur dihet se ai i zbulon gjërat e fshehta në botën e pastër e të preکشme, të panjohurën e bën të njohur dhe të huajën në formë të afërt...”<sup>5</sup>

Imam Sujuti (911 hixhri - Zoti e mëshiroftë!) është i njohur për thënien e tij rreth kësaj çështjeje:

“Dhe pastaj dituria është një det i gjerë dhe i pafund, nuk mund të ecësh mbi të e të mos zhytesh, dhe kush dëshiron ta bëjë një gjë të tillë nuk do të ketë mundësi, madje as që do të mund t’i numërojë të gjitha. Si mund të bëhet një gjë e tillë kur Zoti i Madhëruar iu thotë krijesave të Tij: “*Nuk ju kam dhënë dituri përveçse pak.*” (Isra, 85) Libri ynë Kur’ani është grafullues dhe burim i shkencave. Aty lind dielli dhe në të Zoti i Madhëruar i ka vënë njohuritë për çdo gjë. Aty është çdo udhërrëfim e udhëzim, secili artist nxjerr prej aty atë që e kërkon, juristi i nxjerr parimet e ligjet, ligjet për hallall dhe për haram, gramatikani i nxjerr rregullat gramatikore për të bërë dallimin në fjalë mes gabimit dhe të saktës, retoristi ndjek sistemin e bukur të tij duke i aplikuar mënyrat e elokuencës në thurjen e fjalës; aty ka rrëfime dhe lajmëime që i kuptojnë të mençurit, ashtu siç ka këshilla dhe shembuj me të cilët mahniten mendimtarët dhe përsiatësit. Aty ka edhe shkencë të tjera që nuk mund të rrumbullakohen përpos Atij që i di të gjitha.”<sup>6</sup>

Njeriu që mendon thellë rreth fjalëve të Sujutiut (Zoti e mëshiroftë!) do ta kuptojë qartësinë e mesazhit dhe konceptin e kërkuar dhe, për këtë shkak, mendoj se nuk duhet sqaruar mendimi i tij, që të mos e teproj me komente e fjalë të panevojshme. Rrëfimi i tërë tekstit të tij mbështetet në fjalët: “Vërtetë libri ynë Kur’ani është grafullues i shkencave dhe burim i tyre”, dhe “e sheh se çdo artist nxjerr prej tij dhe aty mbështetet”. Edhe pse fjalët e tij të bëjnë të mendosh për diçka që është ndryshe nga të parët, gjatë studimit dhe zbërthimit të fjalëve të dijetarëve të mëparshëm rreth Kur’anit si përmbledhës i shkencave të të parëve dhe të mëvonshmeve, dhe kjo nuk është pjesë e hulumtimit,<sup>7</sup> përsëri unë i jap liri vetes dhe them se fjalët e Sujutiut duhet të jenë cytëse

---

<sup>5</sup> El-Imadi Ebu Su’ud; *Irashadul-aklis-selim ila mezajal-kitabil-kerim*, (982 hixhri), bot. II, Daru Ihjait-turathil-arabij, Bejrut 2006, vëll. I, f. 50.

<sup>6</sup> *El-Itkan fi ulumil-Kur’an*, vëll. I, f. 18-19.

<sup>7</sup> Këtë çështje e kam shqyrtuar në doktoratën time në gjuhën arabe që titullohet: “*El-It-tixhahat el-fikrijje ved-dinijje fid-derasatil-kur’anijjeti leda ulemail-fil-karnit-tasi’asher vel-ishrin*”, në kapitullin e komentimit shkencor. Libri në fjalë është botuar në

dhe nxitëse të fuqishme për ne që merremi me këto lloje studimesh të përparuara që të shohim begatitë e përgjithshme të mrekullisë kur'anore në sferën e da'vetit, arsimit, bihaviorizimit dhe intelektit. Pse të mos i zhvillojmë e të mbështetemi në shkencat e tilla që kanë të bëjnë me Kur'anin Fisnik!? Nuk ka nevojë të zhvillojmë shkencat e formuara, por duhet t'i përdorim për të përfituar dobi prej tyre deri në Ditën e gjykimit, si p.sh. gramatika, stilistika, retorika dhe duhet t'i ruajmë nga duart e debilëve, ndërsa shkencat që nuk janë zhvilluar, do t'i ndihmojmë që të zhvillohen duke i rishqyrtuar disa lloje të tyre (sa shumë janë llojet e tilla!), që të kemi dobi prej tyre në kohën tonë.

Pastaj, gjatë leximit të literaturës që ka të bëjë me këtë çështje, edhe pse e vlerësoj studimin e të parëve, unë gjeta edhe një çështje të re që është shumë e rëndësishme në zbulimin e shkencave të reja në Kur'anin Fisnik, dhe titulli i këtij studimi është: "Stilistika - vizion në formimin kur'anor",<sup>8</sup> dhe njësoj ashtu siç theksonin dijetarët dobinë e shkencës së shembujve që ka të bëjë me shkencat e Kur'anit, mendoj se kjo çështje gjendet në katër gjëra që nuk mund të gjenden ndokund tjetër: shprehjet e thukëta, preciziteti në kuptim, ngjashmëria e bukur dhe metonimia e saktë, dhe e gjithë kjo paraqet formën më të lartë të retorikës.

Për të arritur një koncept të plotë të kësaj ideje, duhet sqaruar mënyra e funksionalizimit pozitiv të disa shkencave që kanë të bëjnë me Kur'anin Fisnik, ashtu siç duhet sqaruar edhe funksionalizimi i keq dhe negativ i disa shkencave që kanë të bëjnë me Kur'anin Fisnik, nga ana e një numri të madh falsifikatorësh (orientalistë), si dhe të atyre që vazhdojnë rrugën e tyre, që ta kuptojnë më së miri këtë çështje.

Siç duket, përgjigjja fshihet në qëndrimin tonë ndaj metodës së armiqve të Islamit dhe në zbrëthimin e metodave të tyre në raport me Kur'anin Fisnik, gjatë aplikimit të funksionalizimit të keq e të urryer në shumë shkencë e çështje kur'anore për ta thumbuar Librin, të cilin nuk mund ta dëmtojë askush e as që ka ndonjë shpallje tjetër pos tij nga i Urti e i Gjithëfalënderuari.

## 2. Orientalistët dhe funksionalizimi negativ i shkencës së ajeteve mekase dhe medinase

Si përgjigje ndaj pyetjes paraprake rreth funksionalizimit negativ të një pjese dërmuese të shkencave të Kur'anit nga shërbëtorët e sinqertë të djallit dhe ushtarëve të tij nga njerëzit, shërbëtorët e kolonializmit, orientalizmit, misionarizmit, krishterimit, bashkëpunëtorë dhe sionistë, mund të themi se për fat të keq, të tillët na kanë paraprirë me orvatjet e tyre individuale dhe institucionale në funksionalizimin e shkencës së ajeteve mekase dhe medinase për qëllime fetare, për të thumbuar dhe për të hedhur

---

gjuhën shqipe, me përkthim të dr. Muhamed Mustafës, bot. I, 2009, Çabej, Tetovë, Maqedoni.

<sup>8</sup> Dr. Abduladhim Sugajri, *Kitabul-ummeti* - revistë mujore që botohet në Drejtorinë e Hulumtimeve dhe Studimeve Islame në Katar, nr. 151, Ramazan 1433.

dyshim në vërtetësinë e Kur'anit mekas dhe medinas, qoftë në mënyrën e ajeteve ose në karakteristikat e da'vetit dhe stilistikës.

Disa dijetarë theksojnë se mënyrat<sup>9</sup> e orientalistëve për të thumbuar dhe për të formuar dyshim në Librin e Zotit të Madhëruar janë të llojllojshme e të ndryshme. Pjesa dërmuese e tyre ka aplikuar metodën individuale,<sup>10</sup> që ka të bëjë me përkatësinë fetare, shkencore apo historike të orientalistit dhe ndikimin e këtij aspekti në studimet dhe hulumtimet e shkencave islame, duke arritur shkallë të ndryshme, varësisht nga kultura e tyre e jo nga domosdoshmëria të cilën e kërkon studimi shkencor i burimeve islame nga teoritë dhe vizionet...”<sup>11</sup>

Për sa i përket metodës së orientalistëve në thumbimin e ajeteve mekase dhe medinase, ata kanë ndjekur rrugën e stërgjyshërve dhe mësuesve të tyre që ishin si djaj e mashtrues, si p.sh.: Blasheri, Noldeke, Ignaz Goldziher, Shaht, Muir, Bell, Rodinson etj. Orientalistët janë marrë shumë me ndarjet në mes ajeteve mekase dhe medinase, saqë filluan të thonë se ekziston kur'an mekas dhe kur'an medinas me metoda të ndara,<sup>12</sup> nga aspekti i stilit dhe përmbajtjes. Këtë ide e planifikoi Blasheri në librin e tij: “El-Med’hal ilet-Kur’an”, dhe sipas tij Kur’ani Fisnik ka qenë nën ndikimin e dy ambienteve mekase dhe medinase, që kanë dallime të dukshme në mes tyre.

Orientalistët, në përgjithësi, janë mbështetur në shumë çështje të ndryshme për të formuar dyshime, si p.sh.: origjina njerëzore e Kur’anif Fisnik, pastaj dhuna, ashpërsia dhe vrazhdësia në suret mekase,<sup>13</sup> dhe e gjithë kjo tregon për ndikimin e ambientit mekas mbi Pejgamberin a.s., për shkak të përdorimit të mënyrës së të folurit që ishte karakteristikë e banorëve të Mekës, si p.sh., ashpërsia, injoranca e inati.

Orientalistët janë orvatur që t’i zmadhojnë karakteristikat e tilla dhe t’i funksionalizojnë me një metodë negative.<sup>14</sup>

---

<sup>9</sup> Bertraser, Gutelhof, *Usulu naklin-nusus ve neshrul-kutub*, ligjëratë e orientalistit gjerman, e mbajtur në Fakultetin e Filologjisë në vitin 1932, përgatiti Muhamed Hamdi Bekri, vëll. 2, 1995, Mektebetu daril-kutubil-misrijeti, Kajro, f. 10-35.

<sup>10</sup> Shih po ashtu librin e Ebu Lejlës: “*El-Kur’an minel-mendhur-el istishrakij*”, vëll. 1, 2002, Darun-neshri lil-xhami’at, Egjipt, f. 191-231, 237-254.

<sup>11</sup> El-Ajd, Zejd ibën Umer, *El-Mekki vel Medenij fi ujunil-musteshrikine*, f. 8-9.

<sup>12</sup> Për sa u përket dyshimeve që ndjellin orientalistët dhe misionarët arabë rreth çështjes së ajeteve mekase dhe medinase, si p.sh., prifti El-Haddad, shih librin e prof. Muhamed Izzet Deruzi: “*El-Kur’an vel-mubash-shirun*”, vëll. 3, El-Mekteb el-islamij, 1978, Damask, f. 94-115.

<sup>13</sup> El-Ajd, Zejd ibën Umer, *El-Mekki vel Medenij fi ujunil-musteshrikine*, f. 8-9; El-Buti, Kubral-jekiniyat el-keunijje, bot. 9, 1997, Damask, f. 31-74.

<sup>14</sup> Kam hasur replika shkencore, të fuqishme e bindëse rreth këtyre dyshimeve që i ndjellin rreth ajeteve mekase dhe medinase në veprën e shejhit dr. Muhamed Abduladhim Zerkani: “*Menahilul-urfan fi ulumil-Kur’an*”; dr. Ahmed Muhamed El-Fadil: “*El-Itixhahul-ilmanij el-measir fi ulumil-Kur’an*”; dr. Ahmed Idris Ta’an, “*El-Ilmanijjune vel-Kur’anul-Kerim*”; prof. dr. Muna Muhamed Bedihij: “*Et-Tejjarul-ilmanij el-hadith ve meukifuhu fi tefsiril-Kur’anil-Kerimi*” (Zoti e mëshiroftë!).

Dëshirojam që të japim një pasqyrë në këtë drejtim, e jo që t'i shqyrtojmë dyshimet e tyre rreth ajeteve mekase dhe medinase, sepse hulumtimi ynë nuk ka të bëjë me këtë çështje, por thjesht vetëm kisha dëshirë që ta potencoj kujdesin që duhet pasur nga rreziku i këtij funksionalizimi negativ nga ana e “intelektualëve”.

## Kapitulli i dytë

### RËNDËSIA E SHKENCËS SË AJETEVE MEKASE DHE MEDINASE SI DHE DOBITË NGA NJOHURITË PREJ TYRE

Kur'ani Fisnik nuk është shpallur përnjëherë, por i ndarë sipas ngjarjeve dhe rrethanave. Shpallja e tillë përmbante në vete parime, fshehtësi, leksione dhe mësim, për të cilat do të kisha folur gjerë e gjatë sikur të mos ishte natyra e kufizuar e këtij studimi. Zoti i Madhëruar thotë: *“E ata që nuk besuan thanë: “Përse të mos i ketë zbritur atij (Muhammedit) Kur'ani përnjëherë?” Ashtu (e zbritëm pjesë-pjesë) që me të ta forcojmë zemrën tënde dhe Ne e sollëm atë ajat pas ajeti (dalëngadalë).”* (Furkan, 32)

*“Të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, e juve ju është dhënë fort pak dije.”* (Isra, 85)<sup>15</sup>

Zbritja e shpalljes vazhdoi 23 vjet në të dy periudhat, në atë mekase e medinase. Shkenca e ajeteve mekase e medinase nuk ka ekzistuar fare në kohën e Pejgamberit a.s., sepse ata ishin dëshmitarë dhe ishte e natyrshme që nuk kishin nevojë për një çështje të tillë. Pra, si të ndodhte një gjë e tillë kur ata e shihnin zbritjen e shpalljes, vendin, kohën, arsyet dhe pas dëshmisë nuk ndihet nevoja për tregues?! Kështu thoshin disa dijetarë.<sup>16</sup>

Pastaj Zoti i Madhëruar garantoj mbrojtjen e Kur'anit Fisnik duke thënë: *“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.”* (Hixhr, 9)

Mbrojtja hyjnore ngërthen në vete edhe shkencën e ajeteve mekase dhe medinase, së bashku me mbrojtjen e sunnetit të pastër, sepse e sqaron dhe shpjegon në detaje Kur'anin Fisnik. Muslimani nuk mund të ketë dobi të plotë nëse nuk i di shkaqet e shpalljes, lokacionet dhe arsyet e ajeteve.<sup>17</sup>

Nga mbrojtja hyjnore nxjerrim një horizont të lartë kulturor, gjegjësisht orvatjen e popujve për të mbrojtur trashëgiminë intelektuale dhe elementet qytetëruese. Kur'ani Fisnik është bazë e formimit të ummetit islamik, dhe për këtë shkak ne muslimanët obligohemi dhe duhet të kujdesemi maksimalisht dhe me çdo kusht ndaj mrekullisë së tillë, si p.sh., për shkencën e shkaqeve të shpalljes, shkencën e texhvidit, shkencën e ajeteve mekase e medinase, shkencat e gjuhës etj. Horizonti kulturor dhe shkencor i kësaj

---

<sup>15</sup> Forma: “Ve jes'eluneke” është e theksuar e paraprirë në shkronjën “ve” dhe pa të, në pesëmbëdhjetë vende në Kur'anin Fisnik.

<sup>16</sup> Zerkani, Muhamed Abduladhim, *Menahilul-urfan fi ulumil-Kur'an*, vëll. I, f. 196.

<sup>17</sup> Disa dijetarë e quajnë shkencën e ajeteve mekase dhe medinase: “Ilmu ezminetin-nuzul” dhe “ilmu emkinetin-nuzul”.



çështjeje vërehet qartë në thënien e Ibën Mes'udit r.a.: “Pasha All-llahun, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër! Nuk ka zbritur asnjë sure e Librit të Zotit pa e ditur unë se ku ka zbritur, dhe nuk ka zbritur asnjë ajet nga Libri i Zotit pa e ditur unë se për çka ka zbritur. Sikur ta dija se ndokush di më shumë se unë për Librin e Zotit e që është larg (që shkohet tek ai me deve), do të shkoja tek ai”.<sup>18</sup>

Nga dobitë që përfitohen prej shkencës së ajeteve mekase e medinase janë:

I. Dallimi mes abrogimit dhe derogimit.

II. Njohja e historisë së legjislacionit dhe suksesivitetit të tij në mënyrë të përgjithshme.

III. Thellimi i besimit me lartësimin e politikës islame në edukimin e popujve dhe individëve.

IV. Përforcimi i bindjes në këtë Kur'an dhe në arritjen e tij te ne i mbrojtur nga ndryshimi e apokrifi.

V. Njohja e kujdesit të muslimanëve ndaj shkencës së ajeteve mekase dhe medinase për të ditur se çka është shpallur para hixhretit e çka pas tij, çka është shpallur kur ka qenë në qytet e çka në udhëtim, çka është shpallur ditën e çka natën, çka është shpallur gjatë dimrit e çka gjatë verës, çka është shpallur në tokë...<sup>19</sup>

1. Rëndësia e shkencës së ajeteve mekase dhe medinase nga aspekti i disa dijetarëve klasikë

Gjatë hulumtimit tim nuk kam hasur që ndonjë dijetar i mëparshëm të ketë shkruar vepra të posaçme rreth mënyrës së funksionalizimit të shkencave kur'anore, për shkencat e ajeteve mekase dhe medinase, për shkencën e leximit të Kur'anit, përpos në raste të rralla, qoftë në sferën e da'vetit, edukimit ose synimeve të tjera. E gjithë ajo që kam gjetur rreth kësaj çështjeje është se ata kanë shkruar në hulumtimet e tyre rreth shkencës së ajeteve mekase e medinase, duke theksuar mënyrën e njohjes së tyre, karakteristikat dhe metodat tematike ose stilistike etj.

Si shembull konkret mund të theksojmë se Imam Kurtubiu (Zoti e mëshiroftë!), në librin e tij “El-Xhami'u li ahkamil-Kur'an”, thekson autoritetin e lartë të besimtarëve dhe sipas tij: “Secili komentues duhet të dallojë ajetet mekase prej atyre medinase për të ditur se për çka iu fliste Zoti robërve të Tij në fillim të Islamit e çka në fund të Islamit, me çka i obligoi në fillim të Islamit e çka shtoi prej obligimeve në fund të tij. Ajetet medinase abrogojnë ajetet mekase në të shumtën e rasteve në Kur'an e nuk mund që ajetet mekase

---

<sup>18</sup> Nisaburi, Muslim ibën Haxhxhaxh, *Sahihul Muslim*, Daru ihjail-kutubil-arabijjeti, bot. III, 1425, nr. 3088.

<sup>19</sup> *El-Burhan fi ulumil-Kur'an*, vëll. I, f. 187-188.

t'i abrogojnë ajetet medinase, sepse ajeti i abroguar është shpallur para zbritjes së ajetit abrogues..<sup>20</sup>

Pastaj, Imam Shatibiu (Zoti e mëshiroftë), në enciklopedinë e tij rreth usulit, fikhut e tefsirit thotë: “Çështja e njëmbëdhjetë: “Ajete medinas duhet të ketë zbritur ashtu që të kuptohet ai mekas, po ashtu ajetet mekase për të kuptuar njëri-tjetrin sikurse ajetet medinase në bazë të radhitjes në shpallje, sepse në të kundërtën, nuk do të ishte në rregull.

Dhe kjo vërtetohet me faktin se shprehja medinase, në pjesën dërmuese, është e mbështetur në atë mekase, si dhe të fundit prej tyre mbështeten në atë paraprake, dhe kjo vërehet qartë nga leximi i përqendruar, gjegjësisht nëpërmes rrëfimit të përgjithshëm, të posaçmes së përgjithshme, të obligimit të përgjithshëm, të sqarimit të asaj që nuk është sqaruar apo të plotësimit të asaj që nuk duket se është plotësuar...”<sup>21</sup>

Imam Bedreddin Zerkeshi, në enciklopedinë e tij kur'anore “El-Burhan fi ulumil-Kur'an”, e zberthen në detaje këtë çështje nga aspekte të ndryshme, por pa iu qasur çështjes së funksionalizimit të shkencës së ajeteve mekase e medinase për arsye të da'vetit dhe edukimit.<sup>22</sup>

Edhe Imam Sujuti (Zoti e mëshiroftë!) e shqyrton çështjen e ajeteve mekase dhe medinase përafërsisht në mënyrë të njëjtë sikur Imam Zerkeshiu, pa iu qasur çështjes së funksionalizimit të ajeteve mekase e medinase dhe shkencave të tjera për arsye të da'vetit dhe edukimit.<sup>23</sup>

Imam ibën Akajl El-Mekki, në enciklopedinë e tij kur'anore “Ez-Zijadetu vel-ihsan fi ulumil-Kur'an”,<sup>24</sup> po ashtu nuk e ka trajtuar këtë çështje. As në studimin e bekuar që e gjeta në enciklopedinë: “Ulumul-Kur'an min hilali mukat-dimatit-tefsir”, të autorit Shejh Muhamed Safa Shejh Ibrahim Hakki, nuk gjeta gjë.

Dhe në fund, edhe në një studim tjetër që titullohet: “Ulumul-Kur'aninde in Abdilberr” nuk gjeta gjë rreth funksionalizimit pozitiv të shkencave të Kur'anit në da'vet e edukim. Pra, kjo ishte e tëra që kishte të bënte me selefët klasikë rreth kësaj çështje, madje do ta vëreni edhe vetë se ata nuk e kanë shqyrtuar çështjen me të cilën merrem unë.

---

<sup>20</sup> El-Kurtubi, *El-Xhamiul-ahkam vel-mubejjinu lima tedam-menehu mines-sunneti ve ajel-Furkan*, muessesetur-risaleti, bot. I, 2006, vëll. I, Mukadimetul-kitab, f. 4.

<sup>21</sup> Shatibi (790 hixhri), *El-Muvafekat*, tahkik Ebu Ubejde, Daru ibën Affan, bot. I, 1997, vëll. IV, f. 256. Vlen të theksoj se kam hasur një studim të rëndësishëm rreth shkencave të Kur'anit tek Imam Shatibiu nga dr. Shaji ibën Abduhu Es'merij, autor i këshillit arsimor në Fakultetin e Katarit në Universitetin Islamik të Medinës me titull: “*Me'al-imam Esh-Shatibij fi mebahithi min usulul-Kur'an ve tefsirihi*”, ku flet për çështjet që kanë të bëjnë me Kur'anin, tefsirin, kushtet e komentuesit sipas Shatibiut etj.

<sup>22</sup> *El-Burhan fi ulumil-Kur'an*, Imam Zerkeshi, vëll. I, f. 168.

<sup>23</sup> *El-Itkan fi ulumil-Kur'an*, Imam Sujuti, vëll. I, fq. 34-74.

<sup>24</sup> *Ibën Akijle, Ez-Zijade vel-ihsan fi ulumil-Kur'an*, bot. I, 2006, Fakulteti i Sheriatit, Universiteti Sharika, Imaratet e Bashkuar Arabe, fq. 1, 268.

## 2. Rëndësia e shkencës së ajeteve mekase dhe medinase nga aspekti i disa dijetarëve bashkëkohorë

Sa i përket çështjes së angazhimit të disa bashkëkohësve për këtë çështje, shfletova tefsirin “El-Menar” të Reshid Ridasë (Zoti e mëshiroftë!) për parakushtet që parashihen rreth secilit që dëshiron të merret me tefsirin e Librit të Zotit dhe, për fat të keq, nuk gjeta gjë nga ajo që kërkoja unë.<sup>25</sup> Pastaj vazhdova hulumtimin në tefsirin e Shejh Ahmed Meragiut dhe, po ashtu, edhe aty, për fat të keq, nuk munda ta gjej atë që kërkoja.<sup>26</sup> Vazhdova hulumtimin tim në tefsirin “Et-Tahrir vet-tefsir”, të dijetarit të njohur Tahir ibën Ashur, me shpresë se do të gjeja diçka në dhjetë parakushtet që duhen realizuar para tefsirit të Kur’anit, por nuk gjeta gjë për ajetet mekase e medinase.<sup>27</sup> Pastaj vazhdova librin “Mukaddimatut-tefsir”, që titullohej: “Nuzulu Kiramid-difan fi sahati hadaikir-ruhi, verrejhan”,<sup>28</sup> të Shejh Muhamed El-Emin ibën Andullah El-Eremij El-Alevij El-Hararij Esh-Shafi’ijit, dhe as aty nuk gjeta atë që më nevojitej mua.

Për sa i përket Shejhut dhe komentuesit Muhamed Derveze (Zoti e mëshiroftë!), mund të thuhet se ai ka bërë dallimin e metodës mes ajeteve mekase dhe medinase në tefsirin e tij “Et-Tefsir El-Hadith”, duke thënë se metoda e ajeteve mekase është e ndërlidhur me da’vetin në virtytet shoqërore, shpirtërore, njerëzore dhe në tërheqjen e vërejtjes për mëkatet dhe amoralitetin. Aty ka da’vet, zbukurim, kërcënim dhe kahëzim. Metoda mekase, po ashtu, dallon për nga mënyra e retorikës, sepse është e fuqishme dhe depërton thellë në veshë e në zemër. Aty, po ashtu, mbizotëron metoda e këshillave për durim, qetësi, prehje dhe mosmërzitje nga qëndrimet e jobesimtarëve.

Metoda e ajeteve medinase përmban parime, obligime, rregulla adhurimi, rregulla morale, shoqërore, juridike, biheviore, në mënyrën e pyetjeve, përgjigjeve dhe fetvave gjykatësore, shoqërore, morale, familjare e të sheriatit (legjislative).<sup>29</sup>

Studimi i Shejh dr. Subhi Salihut (Zoti e mëshiroftë!), që titullohet “Mebahith fi ulumul-Kur’an”, përmban diçka të re rreth çështjes së ajeteve mekase e medinase. Gjatë shtjellimit të tematikës së ajeteve mekase dhe medinase theksohet se të dy periudhat kanë fazat fillestare, mesatare dhe përfundimtare, dhe si duket këto fjalë autori i ka marrë nga Imami Ebu Kasim Nisaburi. Po ashtu theksohet se shkenca e ajeteve mekase e medinase ka nevojë për pastrimin e transmetimeve, vërtetimin e teksteve dhe përcaktimin e

---

<sup>25</sup> Rida, Sejjid Muhamed Rida, *Tefsirul-Menar*, bot. II, Darul-Menar, Kajro 1947, f. 17.

<sup>26</sup> Meragi, Ahmed Mustafa, *Tefsirul-Meragi*, bot. I, Matba’atu Mustaf El-Halebi ve ve euladihi, 1946, f. 24-30.

<sup>27</sup> Ibën Ashur, Muhamed Dhakir, *Tefsirul-Tahrir vet-tenvir*, bot. I, Ed-Deuletut-tunisijjetu, 1984, Tunis, f. 10-130.

<sup>28</sup> Bot. I, Daru turukin-nuhat, Bejrut, Liban.

<sup>29</sup> Derveze, Muhamed Izzet, *Et-Tefsirul-hadith tertibus-suver kasdut-tenzil*, bot. II, Darul-Garbil-Islamij, Bejrut, vëll. I, f. 126-127.

historisë së vërtetë. Kjo shkencë ka një nevojë më të madhe për një gjë të tillë se sa shkenca e shkaqeve të shpalljes. Të gjitha suret e Kur'anit kanë identitet të njohur dhe histori të qartë dhe, nëse përzihen, atëherë dijetarët e vërtetë iu qasen me standardet e tyre të sakta kritike. Metoda historike-kohore përmban në vete radhitjen kohore, përcaktimin vendor, ndarjen tematike dhe përcaktimin personal, dhe e gjithë kjo nuk mund të jetë larg horizonteve psikike dhe periudhave shoqërore, si dhe nuk mund të mohojë ndikimin e ambientit në jetë e në gjallesa. E gjithë kjo e pengon injorantin që gjatë da'vetit islamik të merret me komentimin e Librit të Zotit.<sup>30</sup> Kështu mendon Imami Ebu Kasim Nisaburi. Interesimi i madh i muslimanëve ndaj transmetimit dhe transmetuesve, si dhe pastrimi, përpikëria dhe preciziteti në radhitjen e sureve dhe të ajeteve kur'anore, sipas zhvillimeve të da'vetit, ndikoi që orientalistët të hedhin gurë e dru kundër transmetuesve dhe transmetimeve, për të mbjellë dyshime në radhitjen e Kur'anit në bazë të sires së Pejgamberit a.s.<sup>31</sup>

Studimi i prof. dr. Shejh Muhamed Muhamed Ebu Shuhbes, po ashtu, ngërthen çështje të rëndësishme, por pa iu qasur kësaj çështjeje me të cilën merrem unë, përpos disa çështjeve të dyshimta pa theksuar thënësit ose burimin e tyre.<sup>32</sup>

Po ashtu nuk ka asgjë të re edhe në librin e Shejh Menna'i El-Kattanit (Zoti e mëshiroftë!) që titullohet: "Mebahithu ulumil-Kur'an", përpos disa vështrime rreth urtësive dhe leksioneve nga zbritja suksesive e Kur'anit Fisnik.<sup>33</sup> Kam hasur disa të dhëna të thukëta në studimin e dr. Adnan Zarzurit, në librin e tij "Ulumul-Kur'an i'xhazuhu ve tarihu teuthikih" rreth kësaj çështjeje që më intereson mua, ku theksohet rëndësia e të kuptuarit të qëndrimeve, situatave dhe pozicioneve në hapat e edukimit e formimit. Kjo shkencë është hyrje në njohuritë rreth karakteristikave rrëfyese dhe biheavioriste të ajeteve mekase e medinase, duke sqaruar se tematika e ajeteve mekase ka të bëjë me besimin, ndërsa tematika e ajeteve medinase me sheriatin. Islami dhe Kur'ani janë: besim, sistem, legjislacion dhe parime.<sup>34</sup>

Në vendtakimin e komentuesve në internet, gjegjësisht në një takim shkencor që zgjati katër sesione me shokët e profesorit të nderuar dr. Muhamed Abdurahman Sha'ji, dr. Abdurahman Mu'ada Esh-Shukrij, dr. Abbas ibën Husejn El-Hazimij (të gjithë janë kolosë të kësaj shkenca), u shqyrtua çështja e ajeteve mekase e medinase në ajetet kur'anore në mënyrë të thellë e në detaje, dhe në vijim po paraqes diçka prej tyre, aq sa më mundëson këtu hapësira e kufizuar. Kur filluan të flasin për shkencën e ajeteve mekase e medinase, dr. Muhamed Abdurahman Shaj'i tha: "Çdo periudhë ka situatat,

---

<sup>30</sup> Salih, Subhi, *Mebahith fi ulumil-Kur'an*, f. 168-169.

<sup>31</sup> Po aty, f. 169, 184.

<sup>32</sup> Ebu Shehbe, Muhamed Muhamed, *El-Med'hal li derasatil-Kur'anil-Kerim*, bot. II, 2001, Darul-livai, Bejrut, f. 219-261.

<sup>33</sup> El-Kattan, Menna'i, *Mebahith fi ulumil-Kur'an*, bot. 5, 2002, Muessesetur-risaleti, Bejrut.

<sup>34</sup> Zarzur, Adnan, *Ulumul-Kur'an ve i'xhazuhu ve tarihu teuthikih*, bot. I, 2005, Amman, Jordan, fq. 211-213.

nevojat dhe kërkesat e veta, dhe nga Kur'ani merret në çdo periudhë ajo që nevojitet. Paramendo sa vuajnë shtetet e botës nga lëndët narkotike dhe sa para harxhojnë për t'i luftuar e për t'i larguar nga shoqëria, e megjithatë përsëri dështojnë. Paramendo se si korri sukses Islami kundër problemit të alkoolit në shoqërinë ku ishte rrënjosur thellë ky fenomen. Atyre që kujdesen për këtë çështje në botën tonë islame iu themi: “Nëse dëshironi t'i luftoni me sukses lëndët narkotike, atëherë duhet ta përforconi anën fetare të rinjtë dhe të mëdhenjtë”.<sup>35</sup>

Këto fjalë përmbajnë një mesazh dhe leksion për ata që punojnë në da'vetin për Zotin e Madhëruar dhe duhen shënuar me shkronja të arta. Pra, ai që merret me da'vet duhet ta njohë mirë gjendjen dhe realitetin e njerëzve ku ata jetojnë, t'i kuptojë mirë tekstet fetare, të kuptojë mënyrën e zbritjes së teksteve të tilla në kohën reale. Ai, po ashtu, duhet t'i njohë nevojat e realitetit të tillë e pastaj të zgjedhë këshillën e përshtatshme për njerëzit. Thirrësi në fe, nëse dëshiron të përmirësojë sjelljen, mendjen dhe besimin e njerëzve, duhet të mbjellë fenë në zemrat e tyre.

Gjatë bisedës së nxehtë rreth kësaj tematike të rëndësishme,<sup>36</sup> shejhu theksoi rëndësinë dhe dobitë që përfitohen nga njohja e ajeteve mekase e medinase, duke thënë: “Shijo mënyrat e Kur'anit dhe dobinë prej tyre gjatë da'vetit në Zot..., dhe ndoshta do të vësh të dhëna të bukura e të dobishme posaçërisht për kohën tonë, si t'i zhvillojmë metodat e da'vetit për të qenë të përshtatshme me situatën dhe me nevojat e njerëzve të kësaj kohe, dhe nuk ka dyshim se dobitë e tilla mund të përfitohen nga shkencat e Kur'anit dhe nga begatitë e Kur'anit.”<sup>37</sup>

Unë them se leksioni e mësimi që mund të merren nga fjalët e prof. Muhamed Kureshiut kanë të bëjnë me zhvillimin e metodave të da'vetit në kohën tonë, në mënyrë që ato të jenë të përshtatshme me gjendjen e njerëzve dhe me përmbushjen e nevojave të tyre intelektuale dhe psikike. E gjithë kjo konsiderohet si dobi dhe bereqet nga shkencat e Kur'anit Fisnik. Edhe i afërmi edhe i largëti e dinë se koha jonë është e mbushur përplot me mjete teknologjike, industriale e shkencore që mund t'i zhvillojnë metodat e da'vetit dhe që ndihmojnë t'iu flitet njerëzve ashtu siç e kuptojnë ata, duke u mbështetur në Kur'an e sunnet. Vetëm dijetarët e kuptojnë këtë çështje të rëndësishme.<sup>38</sup>

---

<sup>35</sup> [www.tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278CVA3ji](http://www.tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278CVA3ji)

<sup>36</sup> Kisha nderin që të jem student i shejhut dr. Muhamed Kureshiut, në Fakultetin e Kur'ani Kerimit në Universitetin Islamik në Medinë, në lëndën e Shkencave të Kur'anit, në vitin 1413/1414, dhe i jam falënderues tërë jetën!

<sup>37</sup> [www.tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278CVA3ji](http://www.tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278CVA3ji)

<sup>38</sup> Rreth karakteristikave të mrekullisë metodologjike, stilistike e ekspresive shih veprën e dr. El-Mu'tit, Abduladhim Ibrahim, *Hasaisut-ta'biril-Kur'anj ve simatihî el-belagijjeti*, bot. I, 1992, Mektebetu Vehbe, vëll. 1, f. 214-320; Derveze, Muhamed Abdullah, En-Nebeul-adhim, *nedharat xhedide fil-Kur'anil-Kerim*, bot. 2, 2006, Bejrut, Liban, f. 76-108; Po ashtu, shih enciklopedinë gramatikore, stilistike dhe retorike: “*Dirasatul-uslubil-Kur'an*” të autorit Abdulhakk, bot. II, Darul-hadith, Kajro, 2007.

Për sa i përket ndarjes së përfitimit dhe sjelljes së njerëzve me shkencën e ajeteve mekase e medinase, njerëzit kanë qëndrime të ndryshme e të llojllojshme, si dhe varësisht nga kapaciteti i tyre shkencor, mundësia e tyre për të ditur dhe nga specializimi i tyre i përpiktë dallohen edhe metodat dhe mënyrat e tyre. Dijetarët e vërtetë përfitojnë nga kjo shkencë, ashtu siç përfitojnë edhe specialistët e tefsirit dhe shkencave të Kur'anit. Po ashtu, edhe studentët e përgjithshëm përfitojnë nga kjo shkencë ashtu siç përfitojnë edhe njerëzit e rëndomtë.

Kjo shkencë nuk është e përkufizuar vetëm për një kategori njerëzish, por prej saj mund të kenë dobi të gjitha kategoritë e njerëzve, p.sh., dijetarët e muxhtehidët kanë nevojë për nasihun e mensuhun. Dijetarët, po ashtu, kanë dobi edhe nga njohja e historisë së shariatit islamik...<sup>39</sup>

Njohja e shkencës së ajeteve mekase e medinase formon një shtyllë të fuqishme në të cilën mund të mbështeten të gjithë thirrësit në fenë e Zotit të Madhëruar. Po ashtu, ajo ndihmon edhe në njohjen e mënyrës së da'vetit, ngjyrat e ligjërimit, shkallëzimin e parimeve, obligimeve, formimit dhe përkryerjes. Da'veti në Zotin e Madhëruar është art peygamberik i lartë, profesion i ndershëm dhe vepër e shenjtë. Ai dallohet për shijen e posaçme kur'anore, të cilën mund ta shijojë realisht vetëm ai që jeton në kopshtin e tij dhe nën hijen e drunjve të tij, nën ajrin e pastër të tij dhe nëse pi ujin e tij të kristaltë. Da'veti ka nevojë për metodë konkrete ndaj çdo lloji të amoralitetit në fe, besim, ligj, krijesë e sjellje. Obligimet e tij bien mbi supet e atij që është i përgatitur për një mësim të tillë, si dhe parimet e shariatit dhe sistemet shoqërore vijnë pas pastrimit të zemrës dhe përcaktimit të qëllimit, derisa të jetë jeta në rrugë të Zotit. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë: *"Thuaj: "Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras tek All-llahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është All-llahu, e unë nuk jam nga idhujtarët."* (Jusuf, 108)

Kush e lexon Kur'anin Fisnik do të vërejë karakteristika të ajeteve mekase që nuk janë në ajetet medinase,<sup>40</sup> pa marrë parasysh se të dytat mbështeten në të parat në parime e ligje, ashtu siç thekson Imam Shatibiu në enciklopedinë e tij "El-Muvafekat".<sup>41</sup>

Pas një orvatje të vazhdueshme hulumtuese, Zoti i Madhëruar më udhëzoi në një burim që konsiderohet pasuri e mendimit tim shkencor, dhe për këtë së pari e së fundi i falënderohem Zotit të Madhëruar. Nuk do të udhëzoheshim sikur të mos na udhëzonte Zoti i Madhëruar! Zoti e shpërbleftë autorin e këtij thesari, profesorin Sejjid Kutub (Zoti

<sup>39</sup> [www.tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278nwAKzN](http://www.tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278nwAKzN).

<sup>40</sup> El-Aijd, Zejd ibën Umer, *El-Mekkij vel Medenij fi ujunil-musteshrikine*, f. 5; Dr. Hasan Azuzi, *Menahilul-musteshrikin el-bahthijje fi dirasatil- Kur'anil-Kerim*, - i këshilloj lexuesit që ta lexojnë këtë vepër për t'i kuptuar mënyrat e tyre hulumtuese për të nxitur dyshime në Kur'an e sunnet. Libri gjendet edhe në versionin elektronik në rrjetin marimangues: [www.muslim-library.com/book,415,1.html](http://www.muslim-library.com/book,415,1.html).

<sup>41</sup> Shatibi, *El-Muvafakat fish-shariatil-islamijeti*, vëll. 1, f. 256; Salih Subhi, *Mebahith fi ulumul-Kur'an*, f. 184.

e mëshiroftë!) dhe tefsirin e tij: “Fi dhilalil-Kur’an”, krahas disa punimeve të tjera të tij.<sup>42</sup> S’ka dyshim se atij i takon merita më e madhe në këtë çështje, për shkak se ai kishte shfaqur interesim të madh ndaj çështjes së mënyrës së funksionalizimit të shkencës së ajeteve mekase e medinase. Ai është përqendruar gjerë e gjatë në tefsirin e sures En’am dhe të disa sureve të tjera të Kur’anit. Ai thekson disa çështje edukative dhe çështje të da’vetit dhe ne, si thirrës në fe, duhet të mendojmë rreth mënyrës së funksionalizimit të tyre dhe dobisë prej tyre. Në fillim të tefsirit të sures En’am, ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë: “Kjo sure është mekase... Nga kur’ani mekas... Kur’ani, i cili vazhdoi t’i zbresë Pejgamberit a.s. plot trembëdhjetë vjet, flet për një çështje, vetëm për një çështje dhe Kur’ani mekas nuk ka kaluar në çështjet që kanë të bëjnë me sistemin e jetës, derisa Zoti e pa se është plotësuar ajo që duhej thënë dhe se besimi është përforcuar e ngulitur në zemrat e njerëzve të zgjedhur nga njerëzia, të cilëve Zoti u caktoi që të jenë bartës të fesë, që të formojnë sistemin real, në bazë të kësaj feje...”<sup>43</sup>

Nga fjalët e lartpërmendura të prof. Sejjid Kutubit nënkuptojmë se Kur’ani mekas nuk e ka tejkalluar çështjen e besimit të pastër, që mbështetet në monoteizmin e pastër e të sinqertë të Zotit të Madhëruar. Kjo është çështja e besimit, e bazës dhe e shtyllës mbi të cilat më vonë do të mbështeten obligimet, ligjet dhe të gjitha detyrimet e tjera fetare.

---

<sup>42</sup> Shih tefsirin e tij në hyrjen e sures El-En’am, Fi dhilalil-Kur’an.

<sup>43</sup> Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur’an*, vëll. 2, f. 3-24.

## Kapitulli i tretë

### KARAKTERISTIKAT METODOLOGJIKE DHE TEMATIKE TË AJETEVE MEKASE E MEDINASE SI DHE DISA APLIKIME NË DA'VET

Në vazhdim do të përqendrohemi në disa degë të shkencës së ajeteve mekase e medinase, e jo në të gjitha çështjet e ndërlidhura me këtë problematikë. Pastaj do të sqaroj funksionalizimin pozitiv të këtyre degëve shkencore me shkencën e ajeteve të tilla. Pra, do të shqyrtoj karakteristikat dhe veçoritë metodologjike, pastaj do t'i krahasoj me fakte e argumente nga jeta jonë aktuale në da'vet e arsim. Do të synoj që, këtë pjesë të shkencës mekase dhe medinase, ta bëj peshore ose dëshmi qendrore për t'u kthyer në Kur'anin Fisnik në të gjitha çështjet tona të da'vetit e arsimit. Nuk kam ndërmend të zgjerohem shumë në këtë çështje, vetëm përpos asaj që është e domosdoshme të jetë si postulat për të ardhmen në shkencë. As që e kam ndërmend të merrem me dyshimet dhe thumbimet e orientalistëve, laikëve, modernistëve, të atyre të infiltruar dhe të atyre që janë të helmuar me mendimin perëndimor - orientalizmi laik modernist iluminist arab e joarab - gjegjësisht me polemikat e tyre rreth tekstit kur'anor e historisë së çështjes së ajeteve kur'anore mekase e medinase, sepse kjo është një çështje tjetër me të cilën janë marrë disa dijetarë të respektuar dhe, nëse dëshironi të përfitoni diçka rreth kësaj problematike, mund t'i lexoni punimet e tyre.<sup>44</sup>

#### 1. Karakteristikat metodologjike dhe tematike të ajeteve mekase e medinase

S'ka dyshim se nëse dëshirojmë të njohim hollësisht një shkencë duhet të shfletojmë literaturën burimore të asaj shkence, sepse në të kundërtën, nuk do të kemi dobi shkencore në të cilën fle zemra e qetësohet truri. Pra, për këtë çështje, duhet të mbështetemi te dijetarët e dalluar të shkencave të Kur'anit, për udhëheqjen dhe lidhshirësinë e të cilëve në shkencat kur'anore ummeti është unanim, dhe këtu konkretisht e ka fjalën për Imam Zerkeshiun dhe Imam Sujutiun (Zoti i mëshiroftë!), sepse secili që vjen pas tyre është mbështetur në punimet e tyre. Edhe pse disa të mëvonshëm janë dalluar në shqyrtimin, parashtrimin dhe analizimin e shkencave të paraardhësve të tyre, përsëri fama u ngelet atyre të parëve, pa marrë parasysh kreativitetin e të mëvonshëmëve.

---

<sup>44</sup> Si shembull konkret theksoj studimin e Shejh dr. Muhamed Abduladhim Zurkanit: “*Menahilul-urfan fi ulumil-Kur'an*”, posaçërisht kapitullin mbi ajetet mekase e medinase, vëll. I, f. 168; Studimin e Shejh dr. Muhamed Ahmed Fadilit: “*El-Ittixhahul-ilmanij el-me'asir fi ulumil-Kur'an*”, studim dhe kritikë, f. 276-307; Studimin e dr. Ahmed Idrisit me titull: “*El-Ilmanijun vel-Kur'anul-Kerim*”, historiku i tekstit, kapitulli mbi ajetet mekase e medinase nga koncepti bashkëkohor, f. 530-589; Studimin e profesoreshës Munna Muhamed Muhjuddin me titull: “*Et-Tejjarul-ilmani el-hadith ve meukifuhu min tefsiril-Kur'anil-Kerim*”, f. 212-302.



Për sa i përket kësaj çështje, Imam Zerkeshiu në librin e tij “El-Burhan fi ulumil-Kur’an”, ka theksuar të gjitha gjërat që kanë të bëjnë me shkencën mekase e medinase.<sup>45</sup> Edhe Imam Sujutiu e ka përcjellë metodën e paraardhësve të tij në librin “El-Itkan fi ulumil-Kur’an”, në mënyrë të hollësishme, përpos faktit se duhen rregulluar dhe radhitur çështjet që ai ka theksuar rreth rregullave, cilësive dhe tipareve të ajeteve mekase e medinase.<sup>46</sup>

Studimi i Shejh dr. Muhamed Abduladhim Zerkanit, “Menahilul-urfan fi ulumil-Kur’an”, sipas meje ka një radhitje më të mirë të çështjeve që kanë të bëjnë me ajetet mekase e medinase, dhe mendoj se do të ishte e dobishme, nga aspekti shkencor, që të theksoj disa karakteristika metodologjike dhe tematike të kësaj çështje, në formën e rezymesë. Në këtë kontekst, ai thotë: “Nga karakteristikat e pjesës mekase theksojmë se më së shumti vërehen këto gjëra:

\* Aty sulmohet ashpër idhujtaria e totemizmi, ashtu siç kritikohen ashpër edhe gënjeshttrat e banorëve të Mekës që ngulnin këmbë në idhujtari e totemizëm.

\* Kur argumentonin dhe mbështeteshin në qëndrimet e baballarëve të tyre, ai u flet për respektin e njeriut që ata e cenonin me këta gurë e idhuj, si dhe i qorton ëndrrat e tyre dhe të baballarëve të tyre të cilët e kishin anashkuar shikimin në vete dhe në horizonte të ajeteve të Zotit.

\* Ai ua ka hapur sytë për t’i parë dëshmitë e të vërtetës në veten e tyre e në gjithësi, duke theksuar argumente të llojllojshme e të ndryshme, në bazë të të cilave ata do të bindeshin në monoteizmin e Zotit, në hyjninë dhe në besimin në ringjallje, në përgjegjësi, dhe në shpërblimin e drejtë e të saktë.

\* Aty flitet për traditat e tyre të këqija, si p.sh., vrasja, derdhja e gjakut, mbytja e vajzave, prekja në nder dhe ngrënia e pasurisë së jetimëve.

\* Aty sqarohen parimet e moralit dhe të drejtat e shoqërisë, qortohet kufri, mëkati, gjynahu, kaosi i injorancës, natyra e thatë, zemra e keqe, ashpërsia në fjalë, duke i nxitur ata që ta duan besimin, nënshtrimin, sistemin, diturinë, dashurinë, mëshirën, sinqeritetin, respektin ndaj të tjerëve, mirësinë ndaj prindërve, respektimin e fqinjëve, pastërtinë e zemrës, pastërtinë e gjuhës etj.

\* Aty rrëfohen ngjarjet që u kanë ndodhur peygamberëve dhe të dërguarve të mëparshëm me këshilla të bukura, me leksione të dobishme, si dhe konfirmohet se nga ligjet hyjnore kozmologjike është shkatërrimi i idhujtarëve, jobesimtarëve dhe se besimtarët dhe mirësia do të ngadhënjëjnë, pa marrë parasysh se sa do të vonohet kjo gjë, përderisa ata kanë ndihmën e të vërtetës dhe besimit.

\* Përmes sureve mekase, që janë të shkurtra e që kanë po ashtu edhe ajete të shkurtra, u drejtohet në mënyrë të thuktë banorëve të Mekës, sepse ata ishin elokuentë, të

---

<sup>45</sup> Zerkeshi, Bedruddin Muhamed ibën Abdullah ibën Behadir (794 hixhri), *El-Burhan fi ulumil-Kur’an*, tahkik Muhamed Ebu El-Fadël Ibrahim, bot. IV, 1428 hixhri, Daru ihajail-kutubil-arabijjeti, Kajro, vëll. 1, f. 187; *Ez-Ziajde vel-ihsan fi ulumil-Kur’an* (1150 hixhri), vëll. 1, f. 216.

<sup>46</sup> *El-Itkan fi ulumil-Kur’an*, vëll. 1, f. 167.

zotët e gjuhës dhe ekspertë në shprehje. Forma e tillë e thuktë në fjalë përputhej me natyrën e tyre gjuhësore.

\* Ligji i ertësisë së lartë hyjnore caktoi që të shkohej në mënyrë graduale në edukimin e individëve, duke u dhënë përparësi gjërave më të rëndësishme. Nuk ka dyshim se besimi, morali dhe traditat janë forma të adhurimit dhe marrëdhënieve precize”.<sup>47</sup>

Për sa u përket karakteristikave të ajeteve medinase, ai thekson:

\* Aty bisedohet për saktësinë e ligjeve, detajet e parimeve dhe llojet e ligjeve qytetare, penale, luftarake, shoqërore, shtetërore, civile dhe llojet e ndryshme të ibadeteve e relacioneve. Për këtë, nëse dëshiron, shih suret Bekare, Nisa, Maide, Enfal, Kital...

\* Aty ftohen në Islam ithtarët e librit, gjegjësisht çifutët dhe të krishterët. Po ashtu, zhvillohet polemikë rreth besimeve të tyre të kota, sqarohet bastardimi i së vërtetës nga ana e tyre dhe falsifikimi e Librit të Zotit, si dhe kërkohet prej tyre që të mbështeten te logjika dhe historia. Nëse dëshiron, shih suret Bekare, Ali Imran, Maide, Fet’h etj.

Më duket se kjo që u tha në këtë pjesë, rreth karakteristikave dhe veçorive të ajeteve mekase e medinase, është e mjaftueshme për t’i krahasuar ato me disa aplikime bashkëkohore të da’vetit, për të parë se sa mund të aplikohet një shkencë e tillë.

## 2. Aplikime praktike të shkencës së ajeteve mekase dhe medinase, si dhe të shkencës së astronomisë

Për sa i përket mënyrës së funksionalizimit të kësaj shkence në jetën tonë të da’vetit, mund të them se ne jemi të obliguar që ta analizojmë atë që dëgjojmë dhe që shohim në njoftimet e ndryshme informative, për t’i krahasuar metodat dhe temat e ligjëratave e të vazeve të tilla me metodologjinë kur’anore. Secili që largohet nga metoda kur’anore në da’vetin në Zot, do të dështojë. Jam shumë i bindur se situata e shoqërive tona bashkëkohore, në Lindje e në Perëndim, nuk dallon shumë nga situata e shoqërisë mekase dhe medinase, kur në mesin e tyre u shpall Kur’ani Fisnik, me qëllim që ta përmirësonte jetën e tyre në besim, moral e shoqëri. Gjatë thirrjes në Islam, duhet të përqendrohemi në përdorimin e argumenteve shkencore dhe kozmologjike mbi ekzistimin e Zotit të Madhëruar, i Cili është i vetëm dhe nuk ka lindur. Ne duhet të përqendrohemi në estetikën e Islamit dhe në bukurinë e Krijuesit, Kreatorit, Formuesit dhe të Mençurit, që është i pastër nga të metat. Kjo bukuri hyjnore nuk mund të shihet përpos vështrimit dhe përsiatjes rreth krijesave rreth nesh, të cilat i ka krijuar Zoti i Madhëruar, pasi në këtë mënyrë shtohet besimi.

Në asnjë mënyrë nuk duhet të dalim në ndonjë tematikë tjetër, para se të përforcohet ideja dhe ëmbëlsia e besimit në zemrën e njeriut, pasi nëse veprojmë ndryshe, atëherë do të ishte sikur ta vilnim frytin para se t’i vinte koha që të piqej. Hadithi i transmetuar nga

---

<sup>47</sup> Zerkani, Muhamed Abduladhim, *Menahilul-urfani fi ulumil-Kur’an*, vëll. 1, f. 193-203.

sahabi i njohur Muadh ibën Xhebeli, kur Pejgamberi a.s. e dërgoi në Jemen dhe ia tregoi mënyrat e da'vetit që duhet t'i aplikonte me ithtarët e Librit në Jemen, është argumenti më i mirë rreth kësaj çështje. Biseda rreth parimeve të sheriatit, para përforcimit të besimit në zemër, është vetëm humbje kohe, punë e kotë dhe bie ndesh me metodën kur'anore dhe udhëzimin pejgamberik në da'vetin në Zot. Nëse ndokush pyet për urtësinë e da'vetit islamik në fillim të periudhës mekase, për ta përforcuar besimin e vërtetë në imanin në Zot dhe në Pejgamberin e Tij e jo edhe në tema të tjera përmirësuese, atëherë mund të themi se përgjigjja më e mirë e një analize të tillë do të ishte fjala e prof. Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) në tefsirin e tij "Fi dhilalil-Kur'an", posaçërisht në hyrjen e sures En'am, ku gjejmë këtë përgjigje të mjaftueshme e bindëse: "Ithtarët e Da'vetit në fenë e Zotit dhe në formimin e sistemit ku aplikohet kjo fe në jetën reale, duhet të qëndrojnë gjatë para kësaj dukurie të madhe, gjegjësisht në dukurinë e sfidimit të Kur'anit mekas gjatë trembëdhjetë viteve për ta përforcuar këtë besim, pa u ndalur në imtësitat dhe ligjet e këtij sistemi që do të aplikohen në shoqërinë islame. Urtësia e Zotit ishte ajo që caktoi si bosht temën e çështjes së besimit, që nga fillimi i mesazhit. Pejgamberi a.s., në fillim të hapave të para të da'vetit, filloi me ftesën e njerëzve që të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, t'ua mësojë njerëzve Zotin e tyre të vërtetë, me qëllim që të adhurojnë Atë e jo ndonjë tjetër..."<sup>48</sup>

Them se ne duhet t'i risjellim këto të vërteta që mungojnë në ligjëratat tona, në shkrimet tona, në panelet tona, në simpoziumet tona, në derset tona dhe në diskutimet tona me të tjerët. Ne sot vërejmë situata dhe rrethana njësoj si ato që ishin në të kaluarën, në periudhën mekase. Në vazhdim do të përmend disa përvoja që i kam parë e që janë në kundërshtim me atë që na urdhëron e që na udhëzon sunneti i Pejgamberit a.s.

Kam parë shumë thirrës në Zot në vendet arabe, evropiane dhe te ne, në Gadishullin Ballkanik, gjegjësisht në Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë, në Mal të Zi, Maqedoni, Shqipëri e Serbi, që e kanë anashkaluar këtë të vërtetë të madhe në da'vetin në Zotin e Madhëruar. Madje të njëjtën gjë e kam hasur edhe në shtete të tjera të botës.

\* Kam vërejtur se shumica prej tyre harrojnë ose qëllimisht bëjnë se harrojnë dhe e lënë anash, me qëllim ose paqëllim, të kuptuarit e natyrës dhe të karakteristikave të Kur'anit mekas.

\* Gjatë takimeve të mia dhe gjatë programeve të tyre në video, të emetuara në rrjetin e internetit, kam vërejtur se shumica prej tyre flasin për gjëra anësore rreth Islamit, duke qëndruar larg çështjeve prioritare dhe të vërtetave të mëdha, në të cilat përqendrohej Kur'ani Fisnik dhe Pejgamberi a.s. në periudhën mekase, gjegjësisht larg asaj që kemi parë gjatë studimit të periudhës mekase e medinase (karakteristikave dhe tematikave të dy periudhave).

\* Kam vërejtur se disa prej tyre kërkojnë aplikimin e ligjeve të sheriatit në sistemet e qeverive laike, - që janë në përgjithësi e në veçanti kundër Islamit, fshehurazi dhe haptazi, si në individë e në shoqëri, ashtu edhe në institucione e qeveri; - a thua se janë në

---

<sup>48</sup> Po aty.

fillim të një rruge me lule e karafila, e jo në fillim të një rruge të gjatë, të vështirë e të mbuluar plot pengesa e ferra.

\* Shoh se prej muslimanëve që kanë besim të dobët, që bëjnë mëkate të mëdha e të vogla, që janë zhytur thellë në zina dhe në kamatë, që i dëmtojnë prindërit, që punojnë me ryshfet, që bëjnë tregti me lavire, bëjnë tregti me lëndë narkotike, nuk punojnë dhe merren me amoralitet, pra prej njerëzve të tillë ata kërkojnë që ta lëshojnë mjekrën, ta ndryshojnë pamjen e jashtme, të vishen ndryshe nga mënyra se si vishen në vendet e tyre, ta aplikojnë këtë metodologji dhe ta përhapin këtë kulturë nëpër institucionet, shkollat e kompanitë në të cilat punojnë, qoftë edhe nëse i dëbojnë nga puna apo shkolla në shtetet e tilla laike! Pra, në vend që të thirrin në teube të sinqertë, në përforcimin e besimit me punë të mirë, në prezantimin e tyre në mexhlise shkencore, në mirësjellje ndaj prindërve e fqinjëve e të përmirësohen gradualisht lart e më lart, ata të mjerët, i thërrasin në përmirësimin e të dukshmes duke braktisur përmirësimin e të padukshmes!

\* I kam parë duke i këshilluar njerëzit që t'i shkurtojnë teshat dhe pantallonat me pretekstin se veshjet tona janë veshje të perëndimorëve jobesimtarë. Pra, sipas tyre, dalja nga situata është veshja pakistaneze, afganistaneze ose arabe!!! Sipas tyre, kjo veshje është veshje islame që theksohet në Kur'an e sunnet!

\* Njerëzit e tillë urdhërojnë ndryshimin e medhhebit juridik hanefi sunnit, të cilit i takojnë dhe të cilin e kanë trashëguar nga gjyshërit e stërgjyshërit e tyre për të pranuar një medhheb tjetër të importuar! Ata argumentojnë se medhhebi hanefi është formuar në bazë të disa haditheve iluzore, se ai nuk është i mirë dhe se nuk duhet punuar sipas rregullave të këtij medhhebi!

\* Një njeri, fjalës së të cilit unë i besoj, më ka treguar se ka parë disa të rinj të tillë ekstremistë duke u kacafytur me xhematin sunnit hanefit brenda xhamisë në një qytet kosovar, duke i akuzuar si jobesimtarë, të pafe dhe se namazi i tyre është i kotë dhe i papranuar!

\* I kam parë dhe dëgjuar duke kërkuar prej femrave që të veshin mbulesën dhe të mbulojnë tërë trupin dhe fytyrën (ose nikab), sepse sipas tyre mbulesa e nënave të tyre, përveç duarve dhe fytyrës, është mbulesë jo sipas shariatit dhe se ngjyra e vetme e mbulesës duhet të jetë e zezë, duke harruar se sheriatu islamik, si mëshirë ndaj njerëzve, nuk ka folur për çështje të tilla duke i lënë të lirë njerëzit që të veprojnë sipas traditës së tyre në vendet ku jetojnë. Nuk ka asnjë tekst të shariatit, as nga Kur'ani e as nga Sunneti, që përshkruan ngjyrën e mbulesës përpos disa kushteve, rregullave e gjërave të përgjithshme, që i kanë përcaktuar fukahatë dhe ulematë për hixhabin sipas shariatit, që mbulesa të mos jetë e tejdukshme, atraktive, e ngushtë e as e hollë. Zoti e mëshiroftë Imamin dhe dijetarin e njohur Shejh Abdullah bin Bazin, i cili në një program “Nurun aled-derbi”, në radio Kur'ani Kerim në Arabinë Saudite, kur flet për dimensionin kulturor dhe tradicional, nga thellësia e zemrës thotë: “Mbulesa e gruas lindore dallon nga mbulesa e gruas perëndimore”. (Dhe këtë fetva ose këtë parim të shariatit mund ta

krahasoj me të gjitha llojet e mbulesave në botë, qoftë në Turqi, Malajzi, Britani,<sup>49</sup> Amerikë, Australi ose Gjermani).

\* Kam vërejtur se shumica prej tyre mbjellin fitne dhe urrejtje në mes grupeve të shoqërisë islame, duke importuar disa fetva nga disa vende arabe që bien ndesh me traditat aktuale, si p.sh., moslejimi i gruas për të vozitur në vendet evropiane apo moslejimi i pjesëmarrjes së saj në jetën e përgjithshme që lejohet sipas Islamit.<sup>50</sup>

\* I kam parë duke i nxitur të rinjtë që të përdorin dhunën duke thyer e shkatërruar gurët e varrezave të muslimanëve e të jomuslimanëve, gjë që kërkoi intervenimin e menjëhershëm të forcave të rendit publik për të qetësuar zjarrin që ndiznin të rinjtë e tillë të edukuar, për t'i vendosur të këta rinj nëpër burgje e në lista të zeza.

\* Kam vërejtur se shumica prej tyre i thumbojnë personalitetet e njohura historike, nacionale, politike, zyrtare e diplomatike të vendeve tona, gjë që krijon një reagim të ashpër nga qarqet qeveritare dhe hapje të proceseve e hetimeve në institucionet dhe simbolet zyrtare fetare në vend.

\* Kam parë se si disa prej tyre kanë trilluar një formë të re të dhunës ndaj njerëzve, të jenë të ashpër, të dhunshëm e agresivë me muslimanët në vendet evropiane dhe në Gadishullin Ballkanik.

\* I kam parë duke diskutuar në minbere çështje të sihirit, magjisë dhe pritjes së sihirit dhe ç'bën magjistari me të sëmurin.

---

<sup>49</sup> Më ka pyetur motra ime -Allahu e ruajt- për qëndrimin e Islamit ndaj votimit të femrës muslimane për politikanët jomuslimanë në vendet perëndimore. Ajo banon në Londër dhe ka nënshtetësi angleze. Unë i jam përgjigjur asaj në mënyrë të shkurtër e të qartë se çdo vend ka karakteristikat e veta kulturore, tradicionale, politike e ligjore, dhe se muslimania/muslimani duhet të ketë kujdes nga kulturat, traditat dhe ligjet që bien në kundërshtim me parimet islame, dhe se nuk ka të keqe nëse i pranon ato që nuk bien në kundërshtim me sheriatin (Kur'anin ose Sunnetin). Ne obligohemi të pranojmë kulturat e mira dhe t'i hedhim ato të këqijat. I kam thënë asaj: "Oj motra ime e vogël dhe e respektuar, mos harro se Londra nuk mund të shndërrohet në Mekë e as Meka në Londër! Të dyja qendrat kanë karakteristika të posaçme kulturore, tradicionale, mjedisore e fetare, dhe se duhet respektuar parimin se ajo që s'lejohet(kuptohet qe nuk kontradikton qartazi tekstet Kur'anore dhe ato profetike) në Mekë, ndoshta lejohet në Londër dhe e kundërta. Ti je ambasadore e Islamit në ato vende, ke hyrë atje me pëlqimin tënd dhe të atyre, ke pranuar nënshtetësinë e tyre me pëlqim dhe kështu ke përgjegjësi ashtu siç kanë vendasit e tjerë të Londrës dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet të veprosh kundër ligjeve kushtetuese të atij shteti me arsyetim se ti je muslimane dhe mbrojtëse e fesë tënde, sepse në të kundërtën ti do të ishe mëkatore. Besoj se libri i mendimtarit musliman dr. Tarik Ramadan me titull "*Te jesh musliman evropian*" është shumë i dobishëm për sqarimin e çështjeve të tilla.

<sup>50</sup> Ebu Shukka, Abdulhalim, *Tahrirul-mer'eti fi asrir-risaleti*, bot. 5, 1999, Darul-Kalem, Kuvajt, vëll. 1, f. 69-102.

\* Ka edhe shumë e shumë situata të tilla të çuditshme e të dyshimta, të cilat s'është vendi të theksohen këtu hollësisht, dhe mendoj se mjafton vetëm kjo që përmenda deri këtu.

Them se ata përsheptuan në pritjen e rezultateve të da'vetit të tyre dhe për fat të keq, rezultatet nuk ishin shpresëdhënëse për shkak se ata i mohonin këto të vërteta të da'vetit me njerëzit, që janë njësoj sikurse muslimanët e rinj të periudhës së Mekës. Kjo ishte nga njëra ana, ndërsa nga ana tjetër, ata kundërshtonin dhe kritikonin thirrësit në fe dhe dijetarët e mëparshëm e më të vjetër në vendet e tilla, si dhe binin ndesh me traditat e zakonet e vendeve ku jetonin, dhe kështu misioni i tyre, parapakisht, ishte e destinuar të dështonte, pa marrë parasysh se ata mendonin se gjoja bënë vepër të mirë.

Unë nuk jam përqendruar vetëm në thirrësit që janë bij të kombit tim, por edhe në ata të territorit arab që veprojnë nëpër media e internet. Dhe as të tillët nuk i gjeta në rrugë më të saktë e as më të mençur se ata që i përmenda pak më parë. Disa thirrës në fe, qofshin arabë ose joarabë, amerikanë, britanikë, apo lindorë në gjuhën angleze, flasin rreth xhinëve, sëmundjeve nga magjia, sihirit, rukjes, martesës me xhinë e njerëz, martesës me shumë gra, martesës së përkohshme, poligamisë, divorcit, bëjnë reagime të ashpra kundër bashkësive fetare e partive politike etj., dhe si duket, djalli ka gjetur mundësi të murmurojë në ta, sepse ata as që mund ta lëvizin përpara botën islame e cila ndahet, përcahet e copëzohet shumë e më shumë.<sup>51</sup>

Besoj se mjafton kjo që theksova në faqet paraprake, rreth aktiviteteve të da'vetit që janë në kundërshtim me Islamin, sepse kemi vërejtur se botën islame e ka kapluar një dëm i madh për shkak të sjelljeve të tilla dhe injorancës së tyre nga mos leximi dhe moskuptimi i natyrës së Kur'anit mekas e medinas dhe mos përfitimit nga kjo shkencë.<sup>52</sup>

Dhe tash, para përfundimit, do të dëshiroja të krahasoj gjendjen e atyre që u përmendën më sipër me udhëzimet e prof. Sejjid Kutubit, për t'iu treguar atyre dhe neve fshehtësinë e fillimit me besimin në da'vet, ashtu siç ishte në periudhën mekase, si dhe për të treguar kuptimin e vërtetë të dëshmisë: "S'ka zot tjetër përveç All-llahut", të cilën e përjetuan arabët idhujtarë gjatë shpalljes, për të kuptuar arsyen se pse i rezistonin da'vetit islamik. Shejhu thotë: "Kjo çështje, që ishte në trurin e mbyllur njerëzor, nuk depërtoi lehtë në zemrat e arabëve. Ata e kuptonin gjuhësisht domethënien e fjalës "Zot" dhe domethënien "S'ka zot tjetër përveç All-llahut". Ata e dinin se Hyjnia nënkuptonte

---

<sup>51</sup> Sikur të kisha të drejtë me shariat, do t'i theksoja emrat e thirrësve të tillë dhe të programeve në internet në youtube, facebook, twitter në gjuhë të ndryshme, gjegjësisht në shqip, boshnjakisht, anglisht, arabisht etj. Por nuk do t'i theksoj njerëzit e tillë që të mos devijoj nga rruga shkencore, sepse në gjatë hulumtimeve shkencore nuk na interesojnë personat, por shërimi i ideve dhe mendimeve e fenomeneve të përhapura dhe, për këtë shkak, i lus lexuesit e nderuar që t'i dëgjojnë personalisht njerëzit e tillë.

<sup>52</sup> Një shikim kontrollues, i shpejtë dhe kritik i disa inserteve me ligjërata në gjuhën shqipe, boshnjake nëpër internet do të zbulojë të vërtetën për të cilën flas këtu, madje edhe përcjellja e inserteve të shumta në gjuhën arabe do të vërtetojë se ata janë preokupuar me çështje sekondare, pa u thelluar fare në çështjet e mëdha fetare.

pushtetin suprem. Ata e kuptonin se monoteizmi hyjnor i Zotit të vetëm nënkuptonte mënjanimin e pushtetit të sihirbërësve dhe udhëheqësve të fiseve, duke iu kthyer tërësisht Zotit. Pushteti i tillë kishte të bënte me ndjenjat, me emocionet, me realitetin e jetës, me pronësitë, me gjykatën, me shpirtin e trupin. Ata e dinin se fjala: “S’ka zot tjetër përveç All-llahut” ishte revolucion kundër pushtetit në tokë dhe konsiderohej si një nga karakteristikat primare të Hyjnisë, ashtu siç ishte edhe revolucion kundër parimeve të nacionalizmit. Ky revolucion zhvillohej edhe kundër ligjeve të cilat Zoti i Madhëruar nuk i lejonte. Pra, për këtë arsye, ata e refuzonin ashpër këtë revolucion dhe i kundërviheshin me luftë, ashtu siç e dinë të gjithë njerëzit. Pse ishte kjo pikënisje e këtij da’veti? Ku qëndronte urtësia e Zotit që e gjithë kjo të fillonte me ashpërsi aq të madhe?<sup>53</sup>

Them se ku janë ata vëllezër e thirrës që e kuptuan këtë të vërtetë? Pse thirrësit e tillë i përshpejtojnë rezultatet brenda ditës? Pse e refuzojnë metodën e tillë kur’anore? Apo ende ndjekin epshin e tyre? Si qëndron puna me ata thirrës që refuzojnë të kuptuarit e fshehtësive të da’vetit dhe edukatës nga shkenca e ajeteve mekase e medinase, si dhe mos përfitimim e dobive nga karakteristikat dhe metodat e periudhës mekase e medinase? Ku është ai nivel i lartë intelektual gjatë punës së tyre me njerëzit? Cila është e vërteta e ligjëratave të tyre fetare në da’vet? Apo thirrësit janë në një anë, e njerëzit në anën tjetër? Vetëm dijetarët i kuptojnë të vërtetat e tilla të da’vetit, që janë të zhdukura e të harruara.

Pastaj, vazhdon prof. Sejjid Kutubi, duke shqyrtuar dhe analizuar leksionet e tilla (tre mundësitë), të gjithë ne që punojmë në da’vetin islamik, pa marrë parasysh gjuhën apo shtetin, duhet t’i kuptojmë këto të vërteta historike të da’vetit në Zot.

Po ashtu, është e sigurt se do të dështojnë dhe do të pësojnë disfatë të gjithë ata që janë larg metodologjisë kur’anore në da’vet të të dyja periudhave, mekase e medinase, dhe ata që nuk përfitojnë nga leximi, kuptimi, përsiatja e komentimi i Kur’anit Fisnik.<sup>54</sup>

## **Zbërthimi i mundësisë së parë**

Prof. Sejjid Kutubi thotë:

“Pejgamberi a.s. është dërguar me këtë fe kur pjesa më e pasur e territorit arab nuk ishte në duart e arabëve, por në duart e të tjerëve. I tërë territori i Shamit në veri ishte në duart e romakëve. I tërë territori i Jemenit në jug ishte nën kontrollin e persianëve, të cilët po ashtu i kontrollonin prijësit arabë. Ai kishte mundësi të thërriste në nacionalizmin arab për t’i bashkuar fiset arabe, që ishin lodhur nga kryengritjet e përleshjet, për ta shpëtuar tokën arabe nga perandoritë kolonizuese. Sikur Pejgamberi a.s. të thërriste në këtë parim,

---

<sup>53</sup> Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur’an*, vëll. 2, hyrje në tefsirin e sures En’amë.

<sup>54</sup> Studimi më i shkëlqyer që ka të bëjë me këtë çështje është ai i dr. Jusuf Kardavit: “*Kejfe neteamelu meal-Kur’anil-Kerim*”; Muhamed Gazali, “*Kejfe neteamelu meal-Kur’anil-Kerim*”; Dr. Halid Es-Sebt, *Kavaidut-tefsir xhem’an ve diraseten*; Shejh Abdurrahman Hasan Habenneke El-Mejdani, *Kavaidut-tedebburil-emthali lil-Kur’anil-Kerim!*

të gjithë arabët do t'i përgjigjeshin ftesës së tij dhe ai nuk do të vuante 13 vjet nga udhëheqësit e Siujdhesës Arabe. Muhammedi a.s. do të ishte udhëheqësi i arabëve, pasi ata t'i përgjigjeshin thirrjes së tij, por urtësia e Zotit të Madhëruar, i cili është i Gjithëdijsëm dhe i Mençur, nuk e udhëzoi Pejgamberin a.s. në këtë drejtim, por e udhëzoi që të luftojë me "S'ka zot tjetër përveç All-llahut!" Pse të përjetonte ai, dhe pakica që i besoi, tërë këtë mundim? Zoti i Madhëruar nuk dëshiroi që Pejgamberi a.s. dhe besimtarët të shkonin në atë rrugë (në rrugën e nacionalizmit arab), sepse e tërë toka është e Zotit dhe duhet të kthehet vetëm në drejtim të Zotit. Kur të jenë drejtuar sinqerisht nga Zoti, do të ngrihet flamuri "S'ka zot tjetër përveç All-llahut". Nuk ishte qëllimi që të shpëtojë toka nga perandori romak apo persian e të përfundojë në perandorinë arabe, sepse të gjithë djajtë janë të njëjtë. Njerëzit duhet të adhurojnë vetëm Zotin dhe ata do të jenë besimtarë të vërtetë vetëm nëse e lartësojnë flamurin: "S'ka zot tjetër përveç All-llahut!", ashtu siç e kuptonte arabi gjuhësisht se s'ka pushtet tjetër përveç atij të Zotit, se s'ka shariat përveç atij të Zotit dhe se s'ka pushtet askush tjetër përveç Zotit.

Nacionaliteti i Islamit është ai i besimit, ku është i barabartë arabi, romaku, persiani dhe të gjithë njerëzit, me të gjitha ngjyrat, nën flamurin e Zotit. Pra, kjo është rruga...!

### **Mundësia e dytë**

Pejgamberi a.s. u dërgua me këtë fe në shoqërinë arabe, ku as pasuria e as drejtësia nuk ndahej në mënyrë të drejtë, sepse vetëm një grup i vogël posedonte edhe pasurinë edhe tregtinë, madje punonte me kamatë për ta shtuar pasurinë dhe për të rritur tregtinë. Ndërsa pjesa dërmuese s'kishte gjë dhe jetonte në uri e varfëri. Ata që kishin pasurinë, posedonin edhe autoritetin e nderin, ndërsa populli asgjë. Pejgamberi a.s. kishte mundësi që të ngrinte flamurin social dhe t'iu shpallte luftë të pasurve. Ai kishte mundësi të thërriste në ndryshimin e situatës, duke ua marrë pasurinë të pasurve për t'ua dhënë të varfërve. Sikur Pejgamberi a.s. të thërriste në këtë drejtim, atëherë njerëzit do të ndaheshin në dy grupe: shumica dërmuese do të ishte me lëvizjen e re kundër palës tjetër dhe i tërë populli do të qëndronte përpara flamurit "s'ka zot tjetër përveç All-llahut", përpos një grupi të vogël. Thuhet se sikur Pejgamberi a.s. të vepronte sipas kësaj ideje, ai do ta përfitonte shumicën dhe pastaj do të shfrytëzonte pozitën si udhëheqës për të përhapur besimin monoteist që ia shpalli Zoti i Madhëruar, gjegjësisht, pas nënshtrimit ndaj tij, ata do t'i nënshtroheshin Zotit të tyre, por Zoti i Madhëruar i cili është i Lartë dhe i Gjithëdijsëm nuk e udhëzoi në këtë mënyrë. Zoti i Madhëruar e ka ditur se kjo nuk është mënyra më e mirë, sepse drejtësia shoqërore duhej të mbështetej në parimin e besimit të përgjithshëm, që mbështetet tërësisht në Zotin e Madhëruar. Në këtë shoqëri do të pranohet drejtësia që urdhërohet nga Zoti i Madhëruar dhe që përhap solidarizimin. Në shoqërinë e tillë nuk do të ketë urrejtje dhe lakmi, e as që punët do të udhëhiqen me shpatë e shkop, me frikë e trishtim. Kështu zemrat nuk do të prishen dhe shpirtrat nuk do



të ngufaten, ashtu siç ndodh kur situatat udhëhiqen nga ndonjë parim tjetër përveç “s’ka zot tjetër përveç All-llahut!”

### **Mundësia e tretë**

Pejgamberi a.s. u dërgua në kohën kur niveli i moralit në Siujdhesën Arabe ishte në shkallën më të ulët, përpos disa vlerave që ekzistonin te beduinët. Sistemi shoqëror ishte shumë i ashpër, sistem për të cilin poeti Zuhekr ibën Ebi Selma thotë:

*Kush nuk mbron nderin me armën e vet  
shkatërrohet dhe kush nuk i dëmton njerëzit, dëmtohet!*

Kjo përputhet me thënien e njohur: “Ndihmoje vëllanë tënd, qoftë dëmtues ose i dëmtuar!”<sup>55</sup>

Alkooli dhe lojërat e fatit ishin traditat me të cilat krenohej ajo shoqëri. Edhe shtëpitë publike të të gjitha formave ishin të përhapura në atë shoqëri, dhe këtë fenomen më së miri e përshkruan Aisheja r.a. e cila thotë: “Kurora në periudhën e xhahilijetit bëhej në katër mënyra,<sup>56</sup> dhe një lloj i kurorës është njësoj si kurora e njerëzve sot”.<sup>57</sup>

Pejgamberi a.s. kishte mundësi që të shpallte thirrje përmirësuese me të cilën do të përforconte moralin, do të pastronte shoqërinë, do të kthjellonte shpirtat dhe do të ndryshonte parimet dhe vlerat... Ndokush mund të thotë se Pejgamberi a.s. kishte mundësi që të bëhej i pari i grupit të njerëzve që do t’i përgjigjeshin thirrjes së tij, e pastaj t’i thërriste në besim, në vend që të ballafaqohej me rezistencën e fortë kundër thirrjes “S’ka zot tjetër përveç All-llahut!” Por Zoti i Madhëruar, i cili është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë, nuk e udhëzoi në atë rrugë, sepse Ai e dinte se morali mund të mbështetet vetëm në parimin e besimit dhe se vetëm në këtë mënyrë do të formohen vlerat, virtytet e pushteti. Pra, vetëm kjo platformë do t’i shpërblejë të sinqertët dhe do t’i ndëshkojë kundërshtarët. Një besim i tillë do të formojë vlera dhe do të përhapë moral, pa pasur nevojë që ndokush t’i kontrollojë me anën e forcës, pushtetit ose dënimit!

Kur përforcohet besimi (pas një mundi të madh), forcohet edhe pushteti në bazë të këtij besimi. Kur njerëzit ta njohin Zotin e tyre dhe kur ta adhurojnë vetëm Atë, atëherë ata do të çlirohen nga të qenët robër, e do të largohen nga pushteti i epsheve. Kur u përforcua “S’ka zot tjetër përveç All-llahut”, Zoti i bëri njerëzit që ta pastrojnë tokën nga romakët e persianët, jo për të sunduar arabi, por vetëm Zoti.

---

<sup>55</sup> Mendoj se shprehja e Sejjid Kutubit rreth kësaj çështje nuk është e saktë, sepse ketu flitet për fjalën e Pejgamberit a.s., gjegjësisht për hadithin e vërtetë që e transmeton Imam Buhariu në Sahih, nga Enes ibën Maliku, botuar në Kajro, Mektebet-selefijjeti, bot. I, 1430 hixhri, nr. 2444.

<sup>56</sup> Buhari, Sahih, nr. 5127.

<sup>57</sup> I sugjeroj lexuesit që të kthehet në tekstin e hadithit, të cilin e transmeton Buhariu në Sahihun e tij, që të mos e zgjas më tepër fjalën time rreth kësaj çështjeje.

Pra, toka u pastrua nga djajtë romakë, persianë e arabë, ashtu siç u pastrua nga tirania shoqërore. Sistemi islam përhapte drejtësinë e Zotit dhe i trajtonte gjërat në bazë të peshores së Zotit. Ai e lartësoi drejtësinë shoqërore në emër të Zotit dhe e quante atë flamur të Islamit, pa i ngjitur ndonjë emër tjetër, përveçse fjalët: “S’ka zot tjetër përveç All-llahut!” Kështu u spastruan shpirtat dhe morali, u spastruan zemrat e shpirtat, pa dhunë e forcë, përpos në disa raste të rralla, sepse në ndjenja u mboll mbikëqyrja dhe vetëkontrolli. Ata kërkonin pëlqimin dhe sevapin e Zotit të Madhëruar dhe frikësoheshin nga hidhërimi dhe dënimi i Tij dhe vetëm frika e tillë ishte mburojë e sigurt nga çdo vepër e keqe. Autoriteti i njerëzve, morali dhe sistemi u lartësuan në çdo sferë të jetës aq lart, saqë asnjëherë më parë nuk kishin qenë në atë nivel. Kjo ndodhi sepse feja aplikohet si shtet, si sistem, si ligj dhe si parim. Ata e kishin ngulitur këtë fe në ndjenjat dhe në jetën e tyre, në formën e besimit, moralit, adhurimit e sjelljes. Kur Zoti ua mësoi të gjithëve këtë gjë, ata e merituan që të jenë bartës të këtij amaneti të madh, gjegjësisht të amanetit se vetëm Zoti ka pushtet në zemra, në ndjenja, në sjellje, në vepra, në shpirta, në pasuri, në pozita dhe në situata të ndryshme. Nuk do të kishte gjë nga kjo metodë e bukur sikur të mos fillonte ashtu siç filloi, sikur të mos ngrihej vetëm flamuri i tillë, gjegjësisht flamuri: “S’ka zot tjetër përveç All-llahut” e asgjë tjetër. Ky da’vet sipërfaqësisht duket i vështirë, por në brendi është i bekuar dhe i lehtë. Metoda e bekuar nuk do të ishte për Zotin sikur të bëhej në emër të nacionalizmit, socializmit ose moralizmit ose nëse i ngjitej edhe ndonjë simbol tjetër flamurit: “S’ka zot tjetër përveç All-llahut!”<sup>58</sup>

Prof. Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) është zhytur thellë në shkencën e ajeteve mekase e medinase (filozofia e periudhës mekase dhe medinase) duke i kuptuar të gjitha aspektet intelektuale, psikike e sociale të kësaj periudhe në da’vetin në Zot, dhe këtë ai dëshiron që t’ua sqarojë atyre që punojnë në da’vet e që përshejtojnë në përfitimin e rezultatit.

Ai, po ashtu, thekson edhe rëndësinë e funksionalizimit të një shkence tjetër nga shkencat e Kur’anit, të cilën e theksova më parë, gjegjësisht ndikimin e shembujve dhe ilustrimit në shpirtin e njerëzve. Në këtë kontekst, ai thotë:

“Natyra e kësaj feje e ka caktuar një gjë të tillë, sepse kjo fe mbështetet e tëra në parimin hyjnor të Zotit Një. Të gjitha rregullat dhe ligjet e saj grafullojnë nga ky burim i madh. Sikurse druri i lartë, i madh e i trashë që ka degë të shumta të gërshetuara e të degëzuara në ajër dhe rrënjë të thella në tokë e sipërfaqe të gjerë sipas madhësisë që ka, po ashtu, e njëjta gjë vlen edhe për këtë fe, sepse sistemi i saj mbizotëron në këtë jetë, i kaplon të gjitha çështjet e njerëzve të mëdhenj e të vegjël, e sistemon jetën e njeriut jo vetëm në këtë dynja, por edhe në botën e ahiretit, jo vetëm në botën e dukshme, por edhe në botën e fshehtë, jo vetëm në marrëdhëniet e dukshme materiale, por edhe në brendi të ndjenjave dhe në botën e fshehtësirave e qëllimeve. Pra, kjo fe është një institucion i gjerë, i madh, i shtrirë dhe i përhapur, dhe për këtë shkak ka nevojë për rrënjë të thella

---

<sup>58</sup> Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur’an*, vëll. 2, hyrja e komentimit të sures Ahkam.

ashtu siç është e gjerë, e madhe, e thellë dhe e përhapur. Kjo është një anë e fshehtësisë dhe natyrës së kësaj feje. Ajo përcakton metodën e formimit dhe vazhdimin, formon ndërtimin e besimit duke e përhapur dhe ngulitur në thellësi të shpirtit. Kjo është një nevojë e formimit të drejtë, garanci e mundësive dhe solidaritetit në mes anës së dukshme të drurit në ajër dhe rrënjëve në thellësi të tokës. Kur përforcohet besimi: “S’ka zot tjetër përveç All-llahut!” në thellësi të madhe, në të njëjtën kohë përforcohet edhe sistemi i cili ka të bëjë me “S’ka zot tjetër përveç All-llahut!” Ky është sistemi i vetëm që e pranojnë shpirtit, pasi që të përforcohet besimi. Shpirtit e tillë e pranojnë këtë besim edhe para se të vijë detajet e sistemit dhe para ardhjes së ligjeve. Dorëzimi i plotë është rezultat i këtij besimi. Këto shpirtit i pranojnë sistemet dhe ligjet e Islamit me pëlqim dhe zemërgjerësi të plotë, pa refuzuar asgjë dhe tentojnë t’i aplikojnë ato me një vrull të madh. Pra, në këtë mënyrë u kuptuan vera, kamata, lojërat e fatit dhe traditat e xhahilijetit, përmes ndikimit të ajeteve të Kur’anit ose të haditheve të Pejgamberit a.s. Pushtetet tokësore orvaten të bëjnë një gjë të tillë përmes ligjeve e vendimeve, pushtetet e propagandës, por kot, sepse dështojnë në çdo aspekt dhe shoqëria vazhdon t’i praktikojë gjërat e ndaluara dhe të këqija.”<sup>59</sup>

Profesor Sejjid Kutubi vazhdon të sqarojë edhe një fshehtësi nga fshehtësitë e periudhës mekase dhe medinase, duke thënë:

“Muslimanët në Mekë nuk e kontrollonin veten e as shoqërinë. Zoti i Madhëruar në fillim ka shpallur vetëm besim dhe moral, dhe nuk ka shpallur ligje e sisteme, të cilat formohen vetëm pas përforcimit të besimit të tillë në thellësi... Kur u formua shteti në Medinë, filluan të shpallen ligjet dhe sistemi që përputheshin me nevojat reale të shoqërisë islame, dhe për të cilat garantonte edhe pushteti. Zoti i Madhëruar nuk donte që ligjet dhe sistemi të shpallehin për t’u praktikuar në Mekë, para se të formohej shteti në Medinë, sepse kjo nuk është në natyrën e kësaj feje. Kjo fe është maksimalisht objektive dhe nuk paramendon problematika për të paramenduar zgjidhje, por vepron sipas realitetit dhe, në bazë të realitetit të tillë, i formon dhe sistemon ligjet, varësisht nga natyra e problemeve.”<sup>60</sup>

Zoti e mëshiroftë imamin, dijetarin dhe shejhun e njohur Muhamed ibën Salih El-Uthejmin, i cili kur thekson, në tefsirin e tij të Kur’anit Fisnik, dobitë nga njohuritë rreth ajeteve mekase dhe medinase, thotë se ka rëndësi:

1. Paraqitja e elokuencës së Kur’anit në formën më të përsosur, duke iu drejtuar njerëzve ashtu siç ndihej nevoja reale.

2. Edukimi i thirrësve në Zotin e Madhëruar dhe udhëzimi i tyre që të përcjellin metodën dhe mënyrën e Kur’anit ndaj njerëzve, duke filluar nga e rëndësishmja në më të

---

<sup>59</sup> Po aty.

<sup>60</sup> Po aty.

rëndësishmen e kështu me radhë, herë në mënyrë të fuqishme e herë në mënyrë të lehtë varësisht nga nevoja.<sup>61</sup>

Zoti e mëshiroftë profesorin dhe shehidin Sejjid Kutub dhe imamin, dijetarin e shejhun Muhamed ibën Salih El-Uthejmin dhe Zoti na furnizoftë me kuptimin e mirë të Librit të Tij Fisnik!

Dhe kështu, falë Zotit të Madhëruar, e përfundova këtë punim shkencor dhe lus Zotin e Madhëruar që të ma pranojë, sepse vetëm për hir të Tij e kam bërë dhe të më shpërblejë Ditën kur asgjë nuk mund të shpaguhet me pasuri e as me lidhje, përpos me zemër të shëndoshë.

Lutja jonë e fundit është: Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve!

### **Përfundimi, rezultatet më të rëndësishme dhe disa këshilla**

Falënderoj Zotin që më mundësoi përgatitjen dhe përfundimin e këtij hulumtimi rreth funksionalizimit pozitiv të shkencës së ajeteve mekase e medinase, dhe pas shfletimit, hulumtimit e kërkimit në shumë fjalë e punime të dijetarëve të njohur, po shënoj rezultatet më të rëndësishme të cilat arrita në përfundim të këtij studimi, për t'ia ofruar lexuesit të respektuar:

1. Studimi vërtetoi se ekziston një nevojë e madhe për studime të tilla rreth funksionalizimit të shkencave të Kur'anit, dhe se ata që punojnë në shkencat e Kur'anit, duhet ta ringjallin këtë lloj të studimeve kur'anore për funksionalizimin e tyre pozitiv.

2. Gjatë studimit konstatova se pjesa dërmuese e dijetarëve të vjetër e bashkëkohorë nuk janë marrë me këtë lloj studimi për ringjalljen e funksionalizimit të shkencave të Kur'anit, përpos disave prej tyre që e kanë theksuar këtë domosdoshmëri.

3. Gjatë këtij studimi kuptova se shumica e orientalistëve të vjetër dhe bashkëkohorë kanë praktikuar funksionalizimin negativ të shkencave të Kur'anit, posaçërisht shkencën e ajeteve mekase e medinase, për të mbjellë dyshime dhe hutime rreth Kur'anit Fisnik.

4. Kam arritur në rezultatin shkencor se çdo shkencë që i shërben Kur'anit Fisnik është po ashtu mrekulli, sepse ka lidhje direkte me librin mrekullues dhe i shërben atij.

5. Studimi zbuloi se disa të rinj entuziastë të da'vetit, në të gjitha vendet, janë larg metodologjisë kur'anore dhe udhëzimeve të sunnetit pejgamberik për sa i përket mënyrës së zbrërthimit të çështjeve të besimit, intelektit e moralit në periudhën mekase dhe medinase.

6. Studimi është përqendruar në çështje të rëndësishme të besimit, së pari për të formuar një shoqëri të pastër islame nga aspekti i besimit dhe sjelljes, duke mos anuar

---

<sup>61</sup> El-Uthejmin, Muhamed ibën Salih, *Tefsirul-Kur'anil-Kerim*, bot. I, 1423, Darul-Xheuzij, Arabia Saudite, vëll. 1, fq. 19-20.

nga çështjet sekondare, të cilat trajtohen vetëm pas formimit dhe përforcimit të besimit të sinqertë monoteist që mbështetet në Kur'an dhe sunnet.

7. Ky studim shpresoj të jetë i dobishëm sepse zbulon se diapazoni i da'vetit islamik në mbarë botën është i ngushtë dhe në mesin e thirrësve ka paqartësi dhe kaos, sepse nuk ka harmonizim konkret në mes aktiviteteve të da'vetit që sistemohen në institucionet e da'vetit në nivel të shtetit apo popullit që të aplikojnë metodologjinë e sistematizuar për t'i shqyrtuar çështjet e da'vetit, mendjes dhe moralit. Pra, çdo thirrës ose hulumtues punon në vete, dhe për këtë shkak këshilloj që të formohet një union qendror ndërkombëtar për da'vet në Zot, sepse kështu do të përcillen aktivitetet e thirrësve në fe dhe, në këtë mënyrë, do të sistematizohen e programohen për të ecur me prioritetet e da'vetit në çdo periudhë kohore.

Dr. Hajredin Hoxha (Kosovari)  
Fakulteti i Sheriatit dhe Studimeve Islame  
Universiteti i Katarit  
Doha - Katar  
Dita e xhuma, 36 Dhul-ka'de, 1433 hixhri  
12.10.2012

## LITERATURA

1. Ebu Shekka Abdulhalim, Tarirul-mer'eti fi asrir-risaleti, bot. V, 1999, Darul-Kalem, Kuvajt.
2. Ebu Shehbe, Muhamed Muhamed, El-Xhed-dal lidirasatil-Kur'anil-Kerim, bot. II, 2001, Darul-livai, Bejrut, Liban.
3. Ebu Lejle, Muhamed Muhamed, El-Kur'an fi mendhuril-istishrakij, bot. I, 2002, Darun-neshri lil-xhamiat, Egjipt.
4. El-Bakilani, Ebu Bekr Muhamed ibën Tajjib, I'xhazul-Kur'an, Darul-me'arif, Kajro, tahkik Sejjid Ahmed Sakar.
5. El-Buhari, Muhamed ibën Ismail, El-Xhamius-Sahih, bot. I, tahkik Muhibuddin Hatib, Mektebetus-selefijeti, Kajro.
6. Burgerstaser, Gothilf, Usulu naksin-nusus ve neshrul-kutub, ligjëratat e orientalistit gjerman në Fakultetin Filologjik në vitin 1932, i përgatiti Muhamed Hamdi Bekri, bot. II, 1945 Mektebetu daril-kutubil-misrijeti.
7. Ibën Ashur, Muhamed Et-Tahir, Tefsirut-tahrir vet-tenvir, bot. I, Ed-dar et-tunisijje, 1984, Tunis.
8. Ibën Ukajle, Ez-Zijade vel-ihsan fi ulumil-Kur'an, bot. I, 2006, botim i Fakultetit të Sheriatit, Universiteti Esh\_sharika, Imaratet e Bashkuara Arabe.
9. Behjuddin, Muna Muhamed, Et-Tejjarul-ilmani el-hadith ve meukifuhu min tefsiril-Kur'anil-Kerim, bot. I, 1429, Darul-jusri, Kajro.
10. El-Buti, Muhamed Seid Ramadan, Kubral-jekinijjat el-keunijje, bot. IX, 1997, Darul-fikril-muasir, Damask.
11. El-Xhurxhani Abdulkahir, Esrarul-belaga, libër elektronik, Mektebetu Mishkat el-islamije (Internet).
12. Hasan Azuzij, Menahixhul-musteshrikin el-bahthijje fid-dirasetil-kur'anijjeti, libër elektronik në El-Mektebetush-shamiletu.
13. Hoxha, Hajredin, El-It-tixhahat el-fikrijje ved-dinije fid-dirasatil-kur'anijje leda ulemail-alban fil-karnit-tasi'i asher vel-ishrin, në gjuhën shqipe, përktheu dr. Muhamed Mustafa, bot. I, 2009, Tetovë MKD.
14. Derraz, Muhamed Abdullah, En-Nebeul-adhim, nedharat xhedide fil-Kur'anil-Kerim, bot. II, Darul-kalem, 2006, Bejrut.
15. Duruze, Muhamed Izzet, Et-Tefsirul-hadith tertibus-suveri hasbet-teuzil, bot. II, Darul-garbil-islamij, Bejrut.
16. Zarzur, Adnan, Ulumul-Kur'an ve i'xhazuhu ve tarihu teuthikihi, bot. I, 2005, Amman, Jordan.
17. Duruze, Muhamed Izzet, El-Kur'an vel-mubeshshirun, bot. III, El-Mektebul-islamij, 1978, Damask.
18. Ramadan, Tarik, En tekune muslimen urubijjen, bot. I, 1998, Darul-fikri, Bejrut.

19. Zerkani, Muhamed Abduladhim, Menakilul-urfan fi ulumul-Kur'an, bot. II, 2000, Darul-kalem, Bejrut.
20. Zerkeshi, Bedruddin Muhamed ibën Abdullah ibën Behadir (794 hixhri), El-Burhan fi ulumil-Kur'an, tahkik Muhamed Ebu El-Fadël Ibrahim, bot. IV, 1428 hixhri, Daru ihajail-kutubil-arabijjeti, Kajro.
21. Es-Sebt, Halid, Kavaidut-tefsir xhem'an ve diraseten, bot. I, Daru Affan, 1996, Rijad.
22. Sejjid Muhamed Reshid, Tefsirul-menar, bot. II, Darul-menar, Kajro 1947.
23. Sujuti, Xhelaluddin, El-Itkan fi ulumil-Kur'an, boti. I, Daru Nublis, 2007, Bejrut.
24. Shatibi, Ibrahim ibën Musa ibën Muhamed El-Garnatij, (790 hixhri), El-Muvafekat, tahkik Ebu Ubejde, Daru ibën Affan, bot. I, 1997.
25. Salih Subhi, Mebahith fi ulumil-Kur'an, bot. 10, Darul-ilmi lil-melajin, Bejrut 1977.
26. Sugajri, Abduladhim, Kitabul-ummeti, revistë mujore që botohet në kuadër të hulumtimeve dhe studimeve islame në Katar, nr. 151, Ramazan 1433.
27. Ta'an, Ahmed Idris, El-Ilmanijun vel-Kur'anul-Kerim, bot. I, 2007, Daru ibni Hazëm, Rijad.
28. Ildajme, Abdulhalik, Dirasatul-uslub lil-Kur'an, bot. II, Darul-hadith, Kajro 2007.
29. El-Uthejmin, Muhamed ibën Salih, Tefsirul-Kur'anil-Kerim, bot. I, 1423, Daru ibën Xhezij, Demmmam, Arabia Saudite.
30. ElImadij, Ebu Seud Mustafa, Irshadul-aklis-selim ila mezajal-Kitabil-Kerim, (982 hixhri), bot. II, Daru ihjait-turathil-arabij, Bejrut, Liban, 2006.
31. El-Ajd, Zejd ibën Umer, El-Mekkij vel-medenij fi ujunil-musteshrikin, libër elektronik në El-mektebetush-shamiletu.
32. El-Gazali, Muhamed, Kejfe neteamelu meal-Kur'anil-Kerim, bot. II, 2000, Muessesetur-risaleti, Bejrut.
33. El-Fadil, Ahmed Muhamed, El-Ittixhahul-ilmanij el-muasir fi ulumil-Kur'an, bot. I, 2008, Merkezun-nakidith-thekafij, Damask.
34. Kardavi, Jusuf, Kejfe neteamelu meal-Kur'anil-Kerim, Mektebetu Vehbe, bot. II, 2002, Kajro.
35. Kurtubi, Ebu Abdullah Ebu Bekër, El-Xhamiul-ahkamil-Kur'an vel-mubejjinu lima tedmunuhu mines-sunneti ve ajel-Furkan tahkik dr. Abdullah ibën Abdulmuhsin Et-Turkij, Muessesetur-risaleti, bot. I, 2006.
36. El-Kattan, Menna, Mebahith fi ulumil-Kur'an, bot. V, 2002, Muessesetur-risaleti, Bejrut.
37. Kutub, Sejjid, Fi dhilalil-Kur'an, Darush-shuruk, bot. III, 1988, Kajro.
38. El-Meragi, Ahmed Mustafa, Tefsirul-Meragij, bot. I, Matba'atu Mustafa El-Babi El-Halebi ve euladuhu, 1946, Kajro.

39. El-Mu'tiu, Abduladhim Ibrahim, Hasaisut-ta'biril-Kur'anj ve simatuhu el-belagijje, bot. I, 1992, Mektebetu Vehbe.
40. Mensur Abdulkadir, Meusuatu ulumul-Kur'an, Darul-kalem el-arabij, bot. I, 2002.
41. El-Mijdani, Abdurrahman Hasan Babenneke, Kavaidut-tedebburil-emthali lil-Kur'an, bot. I, Darul-kalem, Damask, 2000.
42. En-Nisaburi, Muslim ibën Haxhxhaxh, Sahihu Muslim, (El-Musned Es-Sahih el-muhtesar mines-sunen), tahkik Muhamed Fuad Abdalbaki, Daru ihjail-kutubil-arabijjeti, bot. III, 1425.
43. [www.muslimlibrary.com/book,415,1,1.html](http://www.muslimlibrary.com/book,415,1,1.html)
44. [tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278CVA3ji](http://tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278CVA3ji)
45. [www.almeshkat.net/books/opca.php?book=1458&cat=](http://www.almeshkat.net/books/opca.php?book=1458&cat=)



